



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR



ANALIZA VJETORE E PUNËS

2022



24 MARS 2023

RRUGA "JORDAN MISJA" NR.1, 1057 TIRANË

tel/fax 0035542231527; www.gjp.gov.al

ANALIZA VJETORE E PUNËS

NË

GJYKATËN E POSAÇME TË SHKALLËS SË PARË

PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

TIRANË 2022

TABELA E LËNDËS	Faqe
HYRJE	3
I. PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I GJYKATËS	4-10
II. ADMINISTRIMI I GJYKATËS	10-13
1. Këshilli i gjykatës.....	11-12
2. Kryetari.....	12-13
3. Kancelari.....	13
III. PROÇESI I PUNËS NË GJYKATË	14-46
1. Aktorët e sistemit të drejtësisë.....	14
2. Procedurat në gjykatë.....	14
3. Menaxhimi i seancave gjyqësore.....	15-16
4. Zyra e Marrëdhënieve me Publikun dhe Median	16-18
5. Kryesekretaria.....	18-19
6. Arkiva.....	19-22
7. Zyra e Buxhetit dhe Financës	22-37
8. Zyra e IT-së.....	37-45
IV. MARRËDHENIET E GJYKATËS SË POSAÇME TË SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR ME PALËT E TRETA	45-47
V. VEPRIMTARIA E GJYKATËS, AFATET KOHORE PROCEDURIALE DHE VLERËSIMI	48-61
1. Çështjet e paraqitura në gjykatë, kohëzgjatja, statistika mbi ankimin..	48
2. Statistika penale (çështje penale, seanca paraprake, masa sigurimi)....	48-61
VI. PARAQITJE DHE ANALIZË E TREGUESVE STATISTIKORË NË VITE	62-66
VII. OBJEKTIVA DHE REKOMANDIME.....	66-68

HYRJJE

Analiza vjetore e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ka në përmbajtje të saj një përshkrim të përgjithshëm të gjykatës, procesin e punës në gjykatë, menaxhimin e seancave gjyqësore, administrimin e gjykatës, si dhe veprimtarinë e saj në tërësi përgjatë vitit 2022.

Në këtë analizë parashtrohet informacion i detajuar, i cili është pasqyruar në tabela dhe grafikë përsa i përket çështjeve të paraqitura në gjykatë, kohëzgjatjes së tyre, statistika mbi ankimet, cilësisë në gjykim, statistikat mbi çështjet penale, seancat paraprake dhe masat e sigurimit. Përveç sa më sipër, në këtë analizë trajtohen në mënyrë të detajuar edhe treguesit statistikorë ndër vite, si dhe procesi krahasimor me vitet paraardhëse.

I. PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I GJYKATËS

Reforma në Drejtësi është një nga zhvillimet më të rëndësishme ligjore, që ka ndodhur në vendin tonë në 30 vitet e fundit, e cila ka në fokus krijimin e një sistemi ligjor koherent, eficient, të konsoliduar dhe të harmonizuar me standardet ndërkombëtare, sistem që i përgjigjet nevojave dhe shkallës së zhvillimit të vendit, me ndikim të drejtpërdrejtë në forcimin dhe konsolidimin e shtetit të së drejtës, e njëherazi garantimin e funksionimit të parimeve kryesore të tij si: parimi i sigurisë juridike dhe parimi i pavarësisë së sistemit të drejtësisë. Me pritshmëri të larta publike, reforma në drejtësi, si proces i jashtëzakonshëm, gjithëpërfshirës, në të cilin u kombinua ekspertiza më e mirë vendase dhe e huaj me standardet më të larta ndërkombëtare të fushës, me mbështetje të qartë nga partnerët strategjikë SHBA e BE, si dhe konsensusin absolut politik, u materializua me një votim unanim në Kuvend në korrik të vitit 2016.

Një prej institucioneve të reja të krijuara në kuadër të zbatimit të reformës rrënjësore në fushën e drejtësisë ishte edhe Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar¹, e cila në vitin 2022 hyri në vitin e tretë të funksionimit të saj.

Sfidat që rezultuan nga pandemia e Covid 19, hapën edhe horizonte të reja, përkatësisht ngritjen e mekanizmave të komunikimit efikas virtual në mënyrë që të mbahet ritmi i institucionit, në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së rregullt gjyqësore. Përgjatë këtij viti, GJKKO ka ushtruar veprimtarinë e saj deri në muajin tetor 2022 me një trupë gjyqësore të përbërë vetëm nga shtatë gjyqtarë, nga 16 gjyqtarë të planifikuar si pjesë e organikës së kësaj gjykate, duke përmbushur dhe realizuar të gjitha sfidat, në funksion të dhënies së drejtësisë.

Pavarësia e sistemit të drejtësisë, si një element i rëndësishëm i shtetit të së drejtës është e domosdoshme për të garantuar mirëfunksionimin e sistemit të drejtësisë, rritjen e përgjegjshmërisë së magjistratëve, paanësinë e tyre në vendimmarrje. Nga ana tjetër, pavarësia nuk duhet parë si një qëllim në vetvete, e për këtë arsye, ajo duhet të shoqërohet me mjete dhe mekanizmat përkatës të përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies, për të siguruar që sistemi gjyqësor dhe ai i prokurorisë, të veprojnë në përputhje me parimet dhe interesat legjitime të një shoqërie demokratike.

GJKKO zhvillon veprimtarinë e saj, sipas ligjit nr. 95/2016 *“Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”*. Ajo filloi funksionimin më datë 19 dhjetor 2019, në bazë të Vendimit Nr. 286, datë 18.12.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor *“Për fillimin e funksionimit të Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”*,

¹ Në vijim me shkrutimin GJKKO.

duke planifikuar në organikën e gjykatës, trupë gjyqësore të përbërë prej 16 (gjashtëmbëdhjetë) gjyqtarësh.

GJKKO ka në kompetencën e saj tokësore të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe si qendër të ushtrimit të veprimtarisë së saj qytetin e Tiranës. Kompetenca lëndore e GJKKO-së përcaktohet nga neni 75/a i K.Pr.Penale, e cila nuk mund të tejkalojë kompetencën e përcaktuar nga neni 135/2 i Kushtetutës² dhe kryesisht fokusohet në veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, si dhe akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Kryetarit të Bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj, si dhe akuzat kundër ish-funksionarëve të sipërpërmendur.

Kompetencat e GJKKO-së përfshijnë veprat penale të parashikuara në dispozitat e mëposhtme:

1. **Neni 230 i Kodit Penal:** Vepra me qëllime terroriste;
2. **Neni 230/a i Kodit Penal:** Financimi i terrorizmit;
3. **Neni 230/b i Kodit Penal:** Fshehja e fondeve dhe e pasurive të tjera, që financojnë terrorizmin;
4. **Neni 230/c i Kodit Penal:** Dhënia e informacioneve nga persona që ushtrojnë funksione publike ose në ushtrim të detyrës a profesionit;
5. **Neni 230/ç i Kodit Penal:** Kryerja e shërbimeve dhe veprimeve me persona të shpallur;
6. **Neni 231 i Kodit Penal:** Rekrutimi i personave për kryerjen e veprave me qëllime terroriste ose të financimit të terrorizmit;
7. **Neni 232 i Kodit Penal:** Stërvitja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste;
8. **Neni 232/a i Kodit Penal:** Nxitja, thirrja publike dhe propaganda për kryerjen e veprave me qëllime terroriste;
9. **Neni 232/b i Kodit Penal:** Kanosja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste;
10. **Neni 233 i Kodit Penal:** Krijimi i turmave të armatosura;
11. **Neni 234 i Kodit Penal:** Prodhimi i armëve luftarake;
12. **Neni 234/a i Kodit Penal:** Organizata terroriste;
13. **Neni 234/b i Kodit Penal:** Banda e armatosur;

² Neni 135 "...2. Gjykatat e posaçme gjykojnë veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, si dhe akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë 37 të Drejtësisë, Kryetarit të Bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj, si dhe akuzat kundër ish-funksionarëve të sipërpërmendur..."

- 14. Neni 244 (paragrafi 2) i Kodit Penal:** Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike;
- 15. Neni 244/a i Kodit Penal:** Korrupsioni aktiv i nënpunësve të huaj publikë;
- 16. Neni 245 i Kodit Penal:** Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë;
- 17. Neni 245/1 (paragrafët 3 & 4) i Kodit Penal:** Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike;
- 18. Neni 257 i Kodit Penal:** Përfitim i paligjshëm i interesave;
- 19. Neni 258 (paragrafi 2) i Kodit Penal:** Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike;
- 20. Neni 259 (paragrafi 2) i Kodit Penal:** Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike;
- 21. Neni 259/a i Kodit Penal:** Korrupsioni pasiv i nënpunësve të huaj publikë;
- 22. Neni 260 i Kodit Penal:** Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë;
- 23. Neni 312 i Kodit Penal:** Korrupsioni aktiv i dëshmitarit, i ekspertit ose përkthyesit;
- 24. Neni 319 i Kodit Penal:** Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë;
- 25. Neni 319/a i Kodit Penal:** Korrupsioni aktiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare;
- 26. Neni 319/b i Kodit Penal:** Korrupsioni aktiv i arbitrit vendas dhe të huaj;
- 27. Neni 319/c i Kodit Penal:** Korrupsioni aktiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja;
- 28. Neni 319/ç i Kodit Penal:** Korrupsioni pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë;
- 29. Neni 319/d i Kodit Penal:** Korrupsioni pasiv i gjyqtarit ose i zyrtarit të gjykatave ndërkombëtare;
- 30. Neni 319/dh i Kodit Penal:** Korrupsioni pasiv i arbitrit vendas dhe të huaj;
- 31. Neni 319/e i Kodit Penal:** Korrupsioni pasiv i anëtarëve të jurive gjyqësore të huaja;
- 32. Neni 328 i Kodit Penal:** Korrupsioni aktiv në zgjedhje;
- 33. Neni 328/b i Kodit Penal:** Korrupsioni pasiv në zgjedhje;

Veprat penale të kryera në kuadër të organizatave kriminale:

- 34. Neni 28 i Kodit Penal:** Forma të veçanta të bashkëpunimit;
- 35. Neni 333 i Kodit Penal:** Organizata Kriminale;
- 36. Neni 333/a i Kodit Penal:** Grup i strukturuar kriminal;
- 37. Neni 334 i Kodit Penal:** Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grup i strukturuar kriminal.

Përveç sa më sipër, GJKKO gjykon edhe veprat penale si vijojnë:

38. Akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kryetarit të bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj;
39. Akuzat penale kundër ish-funksionarëve të mësipërm, kur vepra është kryer gjatë ushtrimit të detyrës.
40. **Neni 119, 120 i Kodit Penal** dhe të gjitha veprat e tjera penale që iniciohen me kërkesën e viktimës akuzuese.

▪ **-Subjektet e Posaçme edhe për veprat penale që nuk janë në kompetencën e GJKKO-së.**

1. Gjykata e Lartë, me vendimin Nr. 00-2021-712 (23), datë 27.07.2021, ka njehsuar praktikën gjyqësore duke unifikuar se Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar është kompetente për shqyrtimin e të gjitha akuzave penale të ngritura ndaj një subjekti të posaçëm të parashikuar nga neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale, si dhe është kompetente për shqyrtimin e akuzave penale në të cilat akuza në gjykim përfaqësohet nga prokuroria, si dhe për gjykimin e akuzave penale të viktimës akuzuese, të ngritura ndaj një subjekti të posaçëm, sipas nenit 59 të K.Pr.Penale. Kjo ka sjellë si rrjedhojë, një rritje të numrit të çështjeve të regjistruara në GJKKO, kryesisht për veprat penale të parashikuara nga nenet 119 dhe 120/2 të Kodit Penal.

2. GJKKO ka në kompetencën e saj të shqyrtimit edhe kërkesat për marrjen e masave parandaluese me karakter pasuror, në kuadër të ligjit nr.10192, datë 03.12.2009 *“Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”*.

3. GJKKO është gjykata kompetente edhe për shqyrtimin e kërkesave të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, për marrjen e masave parandaluese personale dhe pasurore, sipas parashikimeve të Aktit Normativ Nr.1, datë 31.01.2020 *“Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit dhe sigurisë publike”*.

▪ **-Kriteret e veçanta që duhet të përmbushin gjyqtarët e GJKKO-së.**

Kandidatët për gjyqtarë në GJKKO, referuar parashikimeve ligjore të Ligjit nr.96, viti 2016, *“Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, në Republikën e Shqipërisë”*, duhet të plotësojnë kriteret minimale si më poshtë vijojnë për përvojën profesionale: magjistrati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet si gjyqtar, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar në fushën e

drejtësisë penale ose si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar.

Në këtë kontekst, kandidatët për gjyqtarë në GJKKO, referuar parashikimeve ligjore të Ligjit Nr.95/2016, *“Për Organizimin dhe funksionimin e Institucioneve për të luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”*, i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve të sigurisë përpara emërimit në detyrë, përpara se të caktohet apo punësohet në pozicionin e mësipërm. Asnjë kandidat nuk mund të caktohet në detyrë ose të punësohet pa plotësuar këto kushte.

Po kështu, lidhur me detyrimet ligjore që kandidatët e mësipërm duhet të përmbushin përpara emërimit, vlen të theksohet paraqitja dhe firmosja e deklaratës përkatëse me shkrim për heqjen dorë nga e drejta e tyre për privatësi në telekomunikimet e tyre dhe në të dhënat financiare, të pasqyruara në shtojcat B1 e B2 të ligjit të sipërcituar.

Organi kompetent për emërimin e gjyqtarëve në Gjykatat e Posaçme është Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe para emërimit, kandidatët e mësipërm i nënshtrohen verifikimit të pasurisë dhe figurës, si dhe japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikacione vetjake sipas ligjit.


Në zbatim të dispozitave përkatëse të Ligjit nr.96, viti 2016, *“Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, gjyqtarëve të Gjykatave për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme dhe Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit u sigurohet mbrojtja personale sipas kërkesës, si më poshtë:

- a) Kryetarët e Gjykatave, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme dhe Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit mbrohen me shoqërim, me oficer e nënoficer;
- b) gjyqtarët dhe prokurorët mbrohen me shoqërim, me oficer.

Po kështu, me iniciativën e zv.Kryetares së gjykatës, për amendimin e VKM-së nr. 389, datë 12.06.2019 *“Për kriteret për lëshimin e pasaportës diplomatike dhe asaj të shërbimit”*, aktualisht, gjyqtarët e GJKKO-së janë pajisur me pasaporta diplomatike, duke u lehtësuar ndjeshëm procedurat e udhëtimit të tyre në vendet e BE-së.

GJKKO ka në organikë një staf prej 65 punonjësish, që mbajnë pozicionet e mëposhtme:

Nr.	Pozicioni sipas organikës	Numri
1.	Kryetar	1
2.	Zv/Kryetar	1
3.	Gjyqtarë	14
4.	Kancelar	1
5.	Kryesekretare	1
6.	Sekretare gjyqësore	20
7.	Kryetar i Degës së Buxhetit	1
8.	Specialist finance	1
9.	Specialist i Marrëdhënieve me Publikun	1
10.	Specialist Arkive/Protokolli	1
11.	Specialistë IT	2
12.	Nëpunës gjyqësorë	5
13.	Specialistë të SSHM	4
14.	Magaznier	1
15.	Punonjës sigurie	1
16.	Mirëmbajtës	1
17.	Shofer kryetari	1
18.	Shoferë	5
19.	Sanitare	3
Totali		65



Gjatë vitit 2022, GJKKO është përballur me një volum të madh pune, i krijuar si rezultat edhe i numrit të reduktuar të gjyqtarëve. Në muajin dhjetor 2022, numri faktik i gjyqtarëve të GJKKO-së ka qenë 9 (nëntë) të tillë, nga të cilët 6 (gjashtë) të emëruar dhe 3 (tre) me skemë delegimi.

Në funksion të mbarëvajtjes së punës, GJKKO është mbështetur maksimalisht nga ana e KLGJ-së, që i është përgjigjur në kohë shumë të shpejtë kërkesave për plotësimin e trupave gjykues, si dhe kërkesave të tjera në funksion të zhvillimit të procesit normal të punës.

- Siguria në gjykatë

Referuar Vendimit nr.507, datë 27.07.2022, për një shtesë në Vendimin nr. 597, datë 13.10.2021 *“Për përcaktimin e personaliteteve dhe objekteve të tjera, që ruhen dhe mbrohen nga Garda e Republikës së Shqipërisë”*, Garda e Republikës së Shqipërisë ruan dhe mbron Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, e cila garanton sigurinë e personaliteteve shtetërore dhe objekteve në ruajtje.

Në kuadër të garantimit të sigurisë në gjykatë, gjatë vitit 2022 janë shtuar pikat e rejtat të monitorimit për punonjësit e sigurisë, me monitorim në kohë reale, në tre vendodhje të ndryshme, duke mbuluar kështu në mënyrë të plotë, perimetrimin e gjykatës, brenda dhe jashtë ambienteve të saj.

II. ADMINISTRIMI I GJYKATËS

Administrimi i GJKKO-së realizohet nëpërmjet Këshillit të Gjykatës, Kryetarit dhe Kancelarit, kompetencat e së cilëve parashikohen në ligjin nr. 98, datë 06.10.2016 *“Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”*.

1. Këshilli i Gjykatës

Këshilli i Gjykatës përbëhet nga Zv/Kryetari i Gjykatës në cilësinë e Kryetarit të Këshillit dhe dy anëtarë të tjerë, përkatësisht nga Gjyqtarja me vjetërsinë më të madhe në detyrë dhe Kancelari i gjykatës. Ky Këshill mban dhe ushtron kompetencat që parashikon ligji nr.98, datë 06.10.2016 *“Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”*. Gjatë vitit 2022, Këshilli ka zhvilluar gjithsej 22 mbledhje, në përfundim të së cilave ka disponuar me 22 vendime.

Gjatë vitit 2022, nga Këshilli i GJKKO-së, i është dhënë statusi i nëpunësit civil gjyqësor 4 (katër) punonjësve dhe konkretisht 2 “specialistëve IT”, 1 “specialiste financë/ buxheti” dhe 1 “arkivist”, sipas kriterëve të përcaktuara në ligjin e sipërcituar dhe në Vendimin nr. 338, datë 24.09.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, *“Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për dhënien e statusit të nëpunësit civil gjyqësor, punonjësve në detyrë në gjykata”*. Përveç sa më sipër, Këshilli ka

disponuar me vendimmarrje për sa i përket rekrutimit të 5 sekretareve gjyqësore, nëpërmjet Procedurës së Lëvizjes Paralele, bazuar në Vendimin e KLGJ nr. 622 datë 10.12.2020 *“Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”*. Me Vendimin e Këshillit të Gjykatës Nr.22, datë 29.12.2022, është miratuar dhe ka hyrë në fuqi Rregullorja e Brendshme *“Për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Gjyqësore të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”*, si dhe *“Kodi i Etikës së Administratës Gjyqësore të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”*, akte këto të nxjerra në përputhje me ndryshimet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe me rëndësi të madhe në mbarëvajtjen e veprimtarisë së punës të punonjësve të administratës së GJKKO-së.

Gjithashtu Këshilli ka disponuar edhe për çështje që lidhen me administrimin e gjykatës, siç është miratimi i Projekt Buxhetit për periudhën 2023-2025 të GJKKO-së, Miratimi i Udhëzimit të Zëvendëskryetares së Gjykatës *“Mbi pagesën e orëve të punës në ditët e pushimeve javore dhe festave zyrtare për gjyqtarët e GJKKO-së”*, apo për çështje që kanë të bëjnë me rritjen e sigurisë në ambjentet e Gjykatave të Posaçme, si çështje që kanë të bëjnë me veprimtarinë gjyqësore. Lidhur me këtë të fundit, janë zhvilluar në mënyrë konsektive disa Mbledhje të Përgjithshme të Trupës Gjyqësore, ku pas diskutimeve, është çmuar nga trupa gjyqësore se caktimi dhe ndarja e trupave gjykuese, do të ishte jo eficient, kjo referuar faktit që: GJKKO mbetet e paplotësuar në organikën e saj, duke pasur aktualisht 9 gjyqtarë nga 16 të tillë (theksojmë faktin se dy prej gjyqtareve janë deleguar në tetor të vitit 2022); fakti që me ndryshimet e reja që pësoi Kodi i Procedurës Penale në vitin 2021, një pjesë e mirë e gjyqtarëve kanë pengesa për marrjen pjesë në gjykim, duke qenë se më parë kanë mbajtur cilësinë e gjyqtarit të hetimeve apo seancës paraprake (pra, duke qenë të ezauruar); faktin që çështjet e paraqitura për gjykim pranë GJKKO-së shfaqin kompleksitet, shpeshherë, edhe për shkak edhe të numrit të lartë të të pandehurve, që në varësi të gjykimit kondicionon ndarjen apo pezullimin e çështjes. Në këto rrethana, Këshilli i Gjykatës ka vendosur mosndarjen e trupave gjykues, për shkaqet e cituara më mësipër, deri në ndryshimin e tyre.

2. Kryetari i Gjykatës

Kryetari i GJKKO-së ka përgjegjësi për menaxhimin e përgjithshëm gjyqësor. Ai përfaqëson gjykatën në marrëdhënie me të tretët, qofshin këta aktorë vendas, të tillë si OJF të ndryshme, ashtu edhe organizata ndërkombëtare si OSBE, EURALIUS, USAID, që operojnë me projekte të ndryshme në fushën e gjyqësorit shqiptar.

Vlen të theksohet se GJKKO, në funksion të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, ka luajtur një rol thelbësor, veçanërisht lidhur me raportimin e rasteve korrupsionit në nivele të larta të funksionarëve të lartë shtetërorë dhe publikë, si dhe rastet e krimit të organizuar. Në këtë kuadër, në datat 31.01.2022 deri më 04.02.2022 është zhvilluar një takim midis ekspertësh (gjyqtarë dhe

prokurorë të Gjykatës dhe Prokurorisë së Posaçme), lidhur me rishikimin kolegjal të çështjeve konkrete të praktikës gjyqësore, për sa i takon misionit të TAIEK, në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Po kështu, në kuadër të njohjes të legjislacionit të zbatueshëm që lidhet me integrimin evropian, jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë dhe GJEDNJ-së, si dhe njohjen dhe zbatimin e standarteve që ato mishërojnë, GJKKO u përfaqësua nëpërmjet zv.Kryetares në takimin shpjegues të mbajtur në qytetin e Brukselit, Belgjikë për Kapitullin 23 “*Gjyqësori dhe të drejtat themelore*”, më datë 27.09.2022, si dhe në takimin biletaral të zhvilluar në Bruksel, Belgjikë, po për Kapitullin 23 “*Gjyqësori dhe të drejtat themelore*”, më datat 24 dhe 25.11.2022.

Kryetari mbikëqyr respektimin e etikës gjyqësore, disiplinës në punë dhe solemnitetit, duke bashkëpunuar me Këshillin e Lartë Gjyqësor, në lidhje me vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve. Njëkohësisht, ai kujdeset nëpërmjet dhënies së vendimeve dhe urdhrave për të siguruar respektimin e afateve dhe përdorimit sa më të mirë të burimeve të disponueshme, si dhe aksesin dhe transparencën në gjykatë.

Kryetari i gjykatës, në veprimtarinë e Administratës Gjyqësore, kujdeset edhe për organizimin dhe funksionimin e administrimit gjyqësor në gjykatë në lidhje me veprimtaritë jo gjyqësore, nëpërmjet Kancelarit, duke ndjekur disiplinën në punë, përveç se të gjyqtarëve edhe të punonjësve të tjerë të gjykatës dhe për shkeljet e konstatuara vendos për marrjen e masave disiplinore sipas ligjit.

Gjatë vitit 2022, Kryetari i Gjykatës ka nxjerrë një sërë urdhrash të brendshëm, në funksion të mirëorganizimit të gjykatës për planifikimin dhe përdorimin efikas të fondeve publike, sipas nevojave të gjykatës, ka shqyrtuar kërkesat për dorëheqje të gjyqtarëve që kishin pengesa në gjykim, ka miratuar kërkesat për leje të gjyqtarëve etj.

Pas promovimit të ish kryetarit të GJKKO z.Sandër Simoni, si anëtar i Gjykatës së Lartë, në drejtimin e gjykatës më datë 24.03.2021, u zgjodh si zëvendëskryetare znj.Irena Gjoka, nën drejtimin e së cilës gjykata ka realizuar gjithë objektivat dhe pritshmëritë e saj, në drejtim të mbarëvajtjes së punës, si në aspektiv administrativ, organizativ dhe atë vendimmarrës, -megjithë vështirësitë dhe ngarkesën e krijuar për shkak të vakancave të gjyqtarëve në gjëndjen faktike të organikës së saj.

Veprimtarinë e GJKKO-së ka qenë dhe vijon të mbetet në fokus dhe vëmendje mediatike të lartë, për shkak të rëndësisë së veprave penale që ka në kompetencën e saj funksionale, që lidhen me krimin e organizuar, por dhe format e ndryshme të shfaqjes së korrupsionit, që mbetet një ndër sektorët më problematikë në vend, po kështu edhe për shkak të subjekteve të posaçme që gjykon. Në këtë aspekt, ka pasur pritshmëri të larta, të cilat janë përmbushur më së miri, në funksion të realizimit të qëllimit kryesor të saj që është dhënia e drejtësisë, duke arritur që të sigurojë balancën e duhur, pa cënuar asnjë nga aktorët proceduralë. Si rrjedhim, duke luftuar shfaqjet e reja të formave të kriminalitetit në Shqipëri dhe duke përmbushur nevojën për parandalimin dhe luftimin

e tyre, në kuadër dhe të rekomandimeve lidhur me politikat penale që duhet të ndërmerren referuar masave për luftimin e formave të ndyshme të krimit të organizuar dhe korrupsionit, gjykata ka dhënë kontributin e saj edhe në kuadër të plotësisht të kriterëve nga Republika e Shqipërisë, për antarësim në strukturat evropiane, si ajo e BE-së.

3. Kancelari i Gjykatës

Kancelari është përgjegjës për menaxhimin e administrimit gjyqësor. Ai organizon dhe kontrollon veprimtarinë e përditshme të sekretarisë gjyqësore, si dhe të sektorëve ose zyra të tjera, që bëjnë pjesë në strukturën e gjykatës. Kancelari është përgjegjës për funksionimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve në gjykatë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për teknologjinë dhe sigurinë e informacionit, mbikëqyrjen e mbledhjes dhe përpunimit të saktë të të dhënave, si dhe kujdeset për çështjet e etikës dhe përmbushjes së detyrave nga ana e administratës gjyqësore, gjatë dhe jashtë pjesëmarrjes në gjykim. Duhet theksuar fakti se është punuar maksimalisht dhe në mënyrë të vazhdueshme në këtë aspekt, nëpërmjet rritjes së kërkesës së llogarisë dhe monitorimit të proceseve të punës të administratës gjyqësore, duke përdorur mënyra efikase dhe produktive në funksion të mbarëvajtjes në punë, si mbledhjet me stafin, nëpërmjet një procesi proaktiv, ku dhënia e mendimeve dhe ideve të reja nga ana e administratës ka qenë në qendër të vëmendjes së Kancelarit të GJKKO-së. Gjithashtu, vlen të vihet në dukje fakti se janë zhvilluar edhe takime me grupe pune dhe takime individuale me punonjës të administratës gjyqësore, në kuadër të diskutimit të çështjeve të ndryshme, për efekt të mbarëvajtjes në punën e përditshme.

Kancelari gjithashtu kryeson Komisionin për Kthimin dhe Asgjesimin e Provave Materiale dhe mbikëqyr procesin e ruajtjes dhe asgjesimit të tyre, sipas urdhërimeve të vendimeve gjyqësore.

Gjithashtu, Kancelari kontrollon realizimin e detyrave nga ana e nëpunësve civilë gjyqësorë, lidhur me kryerjen e njoftimeve procedurale, si dhe përmbushjen e urdhërimeve të gjykatës mbi zhvillimin e gjykimit. Në këtë aspekt, është ndjekur respektimi i ligjit dhe rregullores së gjykatës dhe kur është konstatuar moszbatimi i tyre janë aplikuar sipas rastit masa disiplinore.

Rritja e standardeve dhe e performancës në punë të stafit të administratës së GJKKO-së, ka si qëllim krijimin e një ambienti të shëndetshëm, të sigurt dhe të përgjegjshëm pune, duke reflektuar tek publiku faktin se administrata gjyqësore e mbështet veprimtarinë e saj në parimet e profesionalizimit, paanësisë, të transparencës, të shërbimit ndaj publikut, të përgjegjësisë dhe korrektësisë në zbatimin e legjislacionit në fuqi.

Gjatë vitit 2022, Kancelari ka raportuar periodikisht në KLGJ dhe Ministrinë e Drejtësisë lidhur me çështjet mbi administrimin e gjykatës dhe çështje të statistikave gjyqësore.

III. PROÇESI I PUNËS NË GJKKO.

1. Aktorët e sistemit të drejtësisë

Gjatë vitit 2022, sikurse edhe gjatë viteve paraardhëse, GJKKO ka mbajtur një komunikim dhe bashkëpunim shumë të mirë dhe frytdhënës me aktorët e tjerë të sistemit të drejtësisë dhe jo vetëm, ndër të cilat përmenden: Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, KLGJ-ja, Gjykata Kushtetuese, Gjykata e Lartë, gjykatat dhe prokuroritë e rretheve gjyqësore, Ministria e Drejtësisë, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, Kolegji i Pavarur i Apelimit, Shkolla e Magjistraturës, Dhoma Kombëtare e Avokatisë, Policia e Shtetit, Zyrat e Përmbartimit, Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, Zyrat Vendore të Shërbimit të Provës, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, ekspertët dhe çdo institucion tjetër me të cilin ndërvepron në kryerjen e funksioneve dhe veprimtarisë së saj.

2. Proçedurat në GJKKO.

Procedurat e ndjekura dhe zbatuara pranë GJKKO-së mbështeten rigorozisht në dispozitat ligjore të Kodit të Procedurës Penale, ligjit nr. 98, datë 06.10.2016 *“Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, ligjit nr. 95/2016 *“Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”*, Aktit Normativ Nr.1, datë 31.01.2020 *“Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit dhe sigurisë publike”*, Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*, i ndryshuar; ligjit nr. 119/2014 *“Për të Drejtën e Informimit”*, i ndryshuar, Vendimeve të KLGJ-së, Rregullores së Brendshme të GJKKO-së dhe Kodit të Etikës së Administratës Gjyqësore, si dhe Kodit të Etikës Gjyqësore të miratuar me vendimin nr.171, datë 22.04.2021, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

Palët që kanë interes i drejtohen GJKKO-së, me anë të kërkesave apo ankesave, të cilat depozitohen dhe trajtohen nga zyrat përkatëse, sipas objektit të tyre.

Kërkesat e paraqitura nga Prokuroria e Posaçme dhe palët e tjera, pasi verifikohen nga sekretaria gjyqësore regjistrohen dhe sipas rastit, nëse janë kërkesa të fazës së hetimeve paraprake, i kalojnë gjyqtarit të hetimeve paraprake. Kërkesat e tjera i nënshtrohen proçedurës së shortit konform nenit 25/1 të ligjit Nr.98/2016, bazuar në parimet e transparencës dhe objektivitetit. Pas hedhjes së shortit, këto çështje iu kalojnë gjyqtarëve përkatës, për kryerjen e veprimeve të mëtejshme proçeduriale.

Sekretaria gjyqësore regjistron të gjitha kërkesat e depozituara nga prokuroria, të pandehurit, viktimat akuzuese dhe shtetasit në cilësinë e viktimës. Ndryshimet e reja në Kodin e Procedurës Penale kanë synuar rritjen e transparencës së pushtetit gjyqësor, duke fuqizuar rolin e gjykatës dhe duke sjellë si pasojë shtimin e procedurave formale përpara saj. Vlen të përmendet ndryshimi që ka pësuar Kodi i Procedurës Penale lidhur me të drejtat që parashikohen dhe njihen për të

dëmtuarin nga vepra penale “viktima”, ku për herë të parë ky subjekt procedural në seancën paraprake ka rol aktiv dhe duhet të marrë njoftim për seancën e parë gjyqësore.

3. Menaxhimi i seancave gjyqësore

Në GJKKO ndodhen gjithsej 5 (pesë) salla gjykimi, te cilat janë të pajisura me sistem regjistrimi audio, ndërkohë që salla 1 është e pajisur edhe me sistem video regjistrimi.

Më poshtë paraqitet tabela me numrin e seancave audio të zhvilluara, për çdo gjyqtar, për vitin 2022.

3.1 Përdorimi i sistemit Audio.

Paraqitja në përqindje e numrit të seancave gjyqësore, që regjistrohen në sistemin audio dhe shkaqeve, për të cilat procesverbalet mbahen me mjete të tjera (kompjuter apo dorëshkrim).

Tabela: Përdorimi i sistemit të regjistrimit audio në periudhën 1/1/2022 - 31/12/2022

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

Nr.	Gjyqtari	Seanca të regjistruara audio (SA)	Seanca të paregjistruara (SP)	Gjithsej (Total)	Në % (Sasi/Total)
1	Irena Gjoka	419	359	778	53.96%
2	Etleva Deda	514	51	565	90.97%
3	Flora Hajredinaj	776	67	843	92.05%
4	Erjon Çela	557	202	759	73.39%
5	Erjon Bani	533	62	595	89.58%
6	Flojera Davidhi	269	26	295	91.19%
7	Atalanta Zeqiraj	398	167	565	70.44%
8	Rudina Palloj	11	0	11	100%
9	Elsa Ulliri	20	0	20	100%
10	Sokol Pina (i deleguar)	12	0	12	100%
11	Diamela Goxhaj (e deleguar)	35	7	42	83.33%
12	Rexhep Bekteshi (i deleguar)	7	0	7	100%
13	Esmeralda Xhili (e deleguar)	8	0	8	100%
14	Besmir Stroka (i deleguar)	6	0	8	75%
15	Artan Cupi (i deleguar)	3	0	3	100%
16	Migena Laska (e deleguar)	2	0	2	100%
Totali		3570	941	4513	79.10%

Vlen për t’u theksuar fakti se seancat gjyqësore që i përkasin çështjeve të themelit, seancave paraprake, kërkesat penale, kërkesave për sekuestrim e konfiskim sipas Ligjit Antimafia dhe Aktit

Normativ, masave të sigurimit regjistrohen nëpërmjet sistemit audio. Seancat, të cilat nuk regjistrohen në sistemin audio pranë GJKKO-së, i përkasin kryesisht kërkesave për lejim/vleftësim/autorizim/zgjatje përgjimi, kërkesave me objekt ekzekutim letërporosie, si dhe kërkesave për caktim mase sigurimi në mungesë. Kjo, për shkak të ruajtjes së sekretit hetimor. Në këtë kontekst, theksojmë faktin se kjo është arsyeja që regjistrimi i të gjitha seancave audio nuk është në masën 100%.

4. Zyra e Marrëdhënieve me Publikun dhe Median

Koordinatori për të Drejtën e Informimit i garanton medias dhe publikut informacion faktik për çështjet me interes publik, në kohë reale dhe kur nuk është e mundur brenda një periudhe sa më të shkurtër, duke mbajtur kontakt të vazhdueshëm me ta, informacion i cili përcillet në përputhje me ligjin Nr. 119/2014 *“Për të drejtën e informimit”*, si dhe ligjin Nr. 9887 datë 10.03.2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tyre.

Zyra e Marrëdhënieve me Publikun i ka mundësuar medias një mënyrë komunikimi efikase nëpërmjet mjeteve elektronike në mënyrë të drejtpërdrejtë, nëpërmjet bashkëveprimit me gjyqtarët dhe administratën, ku çdo informacion përcillet në kohë reale duke lehtësuar komunikimin.

Kjo zyrë është angazhuar që çdo vendim/urdhër t’u komunikohet mediave dhe gazetarëve, sipas rëndësisë së aktit, si edhe të afishohet në faqen zyrtare të institucionit. Bashkëpunimi me median është trajtuar me përparësi duke i dhënë rëndësinë e duhur, për të vënë në dukje jo vetëm punën e kryer të institucionit, por duke na ndihmuar për të evidentuar mangësitë si dhe për të ndryshuar qasjen e publikut me gjyqësorin, gjyqtarëve me median, evidentimin e problematikave dhe rritjen e besueshmërisë.

Informacioni i nevojshëm i jepet gazetarëve në formë të shkruar në rastet kur kërkimi i tyre është parashtruar me shkrim, në formatin elektronik duke përdorur email-in zyrtar të institucionit si dhe kryesisht ky komunikim kryhet nëpërmjet telefonit dhe mesazheve të shkruara për shpejtësi dhe koherencë të lajmit. Të gjitha kërkesat dhe përditësimi i të dhënave/informacioneve elektronike kalojnë nëpërmjet specialistëve të IT-së së gjykatës, që trajtojnë nën monitorimin e Kancelarit të gjykatës edhe këto kërkesa, që kanë rendësi për rritjen e besimit të publikut tek gjykata. Ndërsa, për sa i përket kërkesave, të cilat përcillen nëpërmjet shërbimit postar dhe në sportelin e gjykatës, ato trajtohen dhe u jepet përgjigje brenda afateve ligjore.

Me qëllim përcaktimin e bazave për përmirësimin e marrëdhënieve të gjyqësorit me median dhe publikun, të kuptuarit prej publikut të mjeteve dhe mënyrës së komunikimit me gjykatat, Këshilli i Lartë Gjyqësor me Vendimin nr. 590, datë 26.11.2020, miratoi **Planin Strategjik të Komunikimit për sistemin gjyqësor**, si dhe rregulloren për komunikimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor me median, një tjetër hap i madh e lehtësues për përmirësimin e punës së punonjësës së marrëdhënieve me median dhe publikun brenda gjyqësorit. Plani i Komunikimit shoqërohet me një Plan Veprimi.

Plani i komunikimit ofron zgjidhje novatore dhe qasjet më të mira për të komunikuar në mënyrë efektive duke shfrytëzuar të gjithë mjetet e komunikimit që mundëson teknologjia. Ai do të përditësohet në mënyrë të vazhdueshme në varësi të zhvillimeve për t'u përshtatur me situata apo prioritete që mund të paraqiten në të ardhmen dhe i takon të gjithë aktorëve që ta jetësojnë atë.

Në funksion të respektimit të të drejtave themelore të informimit dhe aksesit në drejtësi, të publikut dhe të medias, nga ana e Zëvendëskryetares së GJKOO-së, është miratuar urdhëri nr.2188 Prot, datë 30.11.2022 *“Për përcaktimin e detyrave të koordinatores për të drejtën e informimit për publikun dhe mediat”*, ku koordinatores së informimit për publikun dhe mediat, i janë caktuar detyrat e mëposhtme:

1.Dhënie e informacionit lidhur me kërkesat e paraqitura nga publiku dhe mediat, për sa i takon seancave gjyqësore dhe vendimeve të dhëna, në kohë reale, ose brenda një kohe të arsyeshme kur informacioni duhet që të procesohet, në një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme.

2.Vendosjen në faqen zyrtare të gjykatës, të informacionit të përditësuar ditor, lidhur me:

- Procedurën e shortit, duke informuar publikun dhe mediat se cilit trup gjykues i kanë kaluar për shqyrtim dosjet e shortuara;
- Kalendarin javor të gjykimeve, i cili do të publikohet çdo ditë të premte, për javën pasardhëse;
- Njoftime sintetike lidhur me çështjet e rëndësishme me impakt për publikun, duke informuar publikun nëpërmjet një përmbledhje të çdo seance gjyqësore: veprimet proceduriale të kryera, arsyet e shtyrjes së seancës gjyqësore apo vendimi përfundimtar i dhënë nga ana e gjykatës;
- Publikimin e njoftimeve për shtyp të cilat kanë interes të veçantë për publikun;
- Informacione të karakterit orientues dhe edukues për publikun dhe mediat (lidhur me publicitetin e seancave, sigurinë në gjykatë, filmimin brenda ambienteve të gjykatës etj.).

4.1.Mesazhi kryesor

Një sistem gjyqësor që funksionon mbi bazën e parimit të pavarësisë, paanshmërisë, profesionalizmit, transparencës dhe të barazisë së individëve para ligjit, meriton besimin e publikut!

Nisur nga rëndësia që kanë mediat, Plani Strategjik i Komunikimit, pjesë e të cilit është edhe GJKKO, synon rritjen e bashkëpunimit dhe fuqizimin e komunikimit me këta aktorë. Ky komunikim dhe bashkëpunim do t'i shërbejë publikut të gjerë, ndaj, krahas nevojës për të komunikuar me këta aktorë, gjykata duhet t'i shohë këta të fundit në funksion të shumëfishimit të përpjekjeve të saj për të komunikuar me publikun. Ky objektivi do të vijë i materializuar përmes: - Forcimit të koordinimit dhe komunikimit midis GJKKO-së me median duke zhvilluar takime të përbashkëta për të lehtësuar informimin në mënyrë korrekte dhe të shpejtë të qytetarëve; - Komunikimit të vendimeve gjyqësore për çështje që kanë interes të veçantë publik; - Zhvillimit të takimeve informuese periodike me përfaqësues të medias dhe OJF-ve për të rritur informimin e

tyre mbi procedurat e marrjes së informacionit, mbrojtjes së të dhënave personale dhe konfidenciale etj.

4.2. Kërkesat drejtuar GJKKO gjatë vitit 2022

Rritja e besueshmërisë së publikut ndaj sistemit gjyqësor në përgjithësi, si dhe përmirësimi i shërbimeve është qëllim në vetvete i kësaj gjykate. Në zbatim të nenit 11 të ligjit nr. 119/2014 *“Për të Drejtën e Informimit”*, i ndryshuar, pranë GJKKO-së janë regjistruar në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve dhe trajtuar 13 kërkesa, një pjesë e mirë e të cilave janë kërkesa për informacion dhe statistika të kategorive të ndryshme, pa përfshirë komunikimet nëpërmjet e-mailit zyrtar. Kërkesat për të drejtën e informimit, janë përmbushur brenda afateve ligjore. Përditësimi i regjistrit është kryer në përputhje me pikën 2 të nenit 5 të ligjit nr. 119/2014 *“Për të Drejtën e Informimit”*, i ndryshuar.

Zyra e Marrëdhënieve me Publikun dhe Median/Koordinatorja e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka si funksion njohjen e veprimtarisë së Gjykatës si dhe vendosjen dhe konsolidimin e marrëdhënieve të Gjykatës me palët e interesuara, me qëllim transparencën dhe rritjen e besimit të publikut ndaj pushtetit gjyqësor. Për përmirësimin e marrëdhënieve të Gjykatës me publikun dhe me median, Koordinatorja përpunon materialin e ardhur që lidhet me seancat gjyqësore/veprimtarinë gjyqësore në përgjithësi dhe posaçërisht me atë të kësaj Gjykate, duke ia bërë ato të njohura Kryetares dhe trupës gjyqësore. Përgatitja e njoftimeve me karakter informues mbi veprimtari të ndryshme të Gjykatës (seminare, mbledhje pune, takime pune apo me delegacione të gjykatave të tjera apo delegacione e përfaqësi të organizmave ndërkombëtarë), drejtuar medias duke i dërguar ato për botim apo transmetim; gjithashtu, nën kujdesin e gjyqtarit të medias, harton njoftime për shtyp mbi vendimmarrjen gjyqësore të Gjykatës, si edhe për çdo vendim gjyqësor të Gjykatës harton deklaratë për shtyp, e cila pasqyrohet tashmë edhe në faqen e re të internetit të Gjykatës. Edhe këtë vit jemi kujdesur për studentët praktikantë të programit mësimor viti II Master Profesional Penal, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, të cilët zhvillojnë praktikën/internship pranë gjykatës sonë. Zyra e marrëdhënieve me Median dhe Publikun është kujdesur gjithashtu për anonimizimin/redaktimin gjuhësor të vendimeve të Gjykatës si dhe çdo material tjetër që përgatitet në emër të saj. Në bashkëpunim me Zyrën e Protokollit dhe Kryesekretarinë ka regjistruar, ndjekur në kthimin e përgjigjeve për të gjitha shkresat që i drejtohen Gjykatës duke arkivuar shkresat dhe korrespondencat sipas rregullave të parashikuara për këtë qëllim nga Ligji për të Drejtën e Informimit; është kujdesur duke përcjellë të gjithë praktikën brenda afateve të kërkuara në kthimin e përgjigjeve, veçanërisht kërkesa që lidhen me statistika dhe vendime gjyqësore.

5. Kryesekretaria.

Kompetencat e Kryesekretarisë dhe sekretarisë gjyqësore parashikohen shprehimisht në nenin 43-44 të ligjit nr. 98/2016 *“Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”*, i

ndryshuar. Kryesekretari ka në kompetencë bashkërendimin, organizimin dhe ndarjen e punës së zyrës së sekretarisë nën drejtimin e kancelarit të gjykatës. Kryesekretari ushtron kompetencat e mëposhtme: a) lëshon vërtetime për të dhënat e kërkuara nga palët nga regjistrat në gjykatë; b) nënshkruan të gjitha aktet procedurale që kërkojnë njoftime procedurale, siç janë: i) vendimet gjyqësore që bëhen përfundimtare; ii) vendime përfundimtare dhe të ndërmjetme që dërgohen për ekzekutim; iii) ekstrakte dhe fotokopje të njësuara me origjinalin të akteve të gjykatës; iv) të gjitha aktet e tjera të nxjerra nga gjykata, krahas nënshkrimit të personit që i ka përgatitur; c) çdo detyrë tjetër e përcaktuar me ligj.

Kryesekretaria ka përballuar një ngarkesë të madhe pune, gjë që vërehet nga numrat në rritje të çështjeve/kërkesave penale të regjistruara e të gjykuara gjatë këtij viti, duke filluar që nga përgjimet, masat e sigurimit e në vijim.

Nga stafi i kryesekretarisë vazhdon të ofrohet shërbim gjatë orarit zyrtar 08.00-16.00. Në zyrën e Kryesekretarisë ofrohen shumë shërbime, të tilla si: regjistrimi i kërkesave të ardhura nga palët dhe prokuroria, për të cilat kryehet verifikim paraprak, kryerja e veprimeve të komunikimeve të vendimeve, ankimeve, masave, IT, ftuesve etj. Gjatë vitit 2022 janë trajtuar dhe u është kthyer përgjigje, një numri të madh shkresash, të tilla si: kërkesa nga institucionet e ndryshme, Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Gjykatave dhe Prokurorive të rretheve, Komisariateve të Policisë, Zyrrave të Përmbarimit, Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, Zyrrave Vendore të Shërbimit të Provës, kërkesa e ankesa nga qytetarët, shkresa për dërgim vendimesh e kthim aktesh prokurorisë, dërgim vendimesh Ministrisë së Drejtësisë, etj.

Me ndryshimet e reja që pësoi Kodi i Procedurës Penale në vitin 2021, ku parashikohet njoftimi i vendimit të arsyetuar palëve në proces, është rritur ndjeshëm volumi i punës në sekretarinë gjyqësore. Kjo ngarkesë shpjegohet si rezultat i faktit se, vendimet e GJKKO-së në tërësinë e tyre janë voluminoze, si pasojë të specifikës që ato kanë, qoftë lidhur me numrin e lartë të të pandehurve, apo numrin e madh të akuzave për të cilat janë hetuar dhe gjykuar këta të pandehur. E njëjta gjë vlen edhe për masat e sigurimit, gjë që krijon një volum të madh pune për punonjësit e administratës gjyqësore, si dhe passjell rritje të kostos së shpenzimeve të gjykatës për njoftimin e akteve palëve në proces. Një problematikë e hasur në këtë aspekt, është njoftimi i të pandehurve të gjykuar në mungesë, veçanërisht në rastin kur adresat e vendosura në dispozicion nuk janë të sakta e të plota dhe bëjnë të pamundur apo vështirësojnë realizimin e njoftimit nga ana e shërbimit postar.

6. Arkiva.

Specialisti i zyrës së sekretari-arkivit, administron dokumentacionin arkivor gjyqësor i cili përpunohet nga ana tekniko-shkencore, me një efikasitet të lartë si një kërkesë e domosdoshme e punës arkivore. Objektivat e kësaj zyre janë realizuar në tërësi, duke rritur performancën e veprimtarisë së kësaj zyre, në shërbimet që ajo mbulon, brenda një kohe të arsyeshme, në përputhje

të plotë me të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për punën me dokumentet zyrtare në Republikën e Shqipërisë.

Në zbatim të detyrave dhe orientimeve të lëna nga Kryetari dhe Kancelari i gjykatës, nga ana e zyrës së sekretari-arkivit janë përgatitur materiale apo shkresa informuese që i janë drejtuar Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor. Është informuar dhe raportuar në kohë për problematikat ekzistuese dhe eventuale në lidhje me kushtet e ruajtjes së fondit arkivor, përpunimit tekniko-shkencor të dokumentacionit arkivor gjyqësor/administrativ si dhe masat që duhet të merren për realizimin e detyrave sipas përcaktimeve ligjore për arkivat. Ka filluar procesi i evidentimit dhe përpunimit të dokumenteve gjyqësorë dhe administrativë për vitet (2020-2021).

Janë marrë masat e nevojshme për hapjen, mbajtjen dhe ruajtjen e regjistrit të korrespondencës për të evidentuar dokumentet që krijohen dhe ato që depozitohen në gjykatë si: Urdhëra, Vendime, korrespondencë zyrtare e zakonshme ose e klasifikuar dhe janë përcjellë pa vonesë shkresat Kryetarit të gjykatës. Janë marrë masa për mbajtjen e regjistrit të hyrjes së dokumenteve gjyqësorë në arkivë, regjistrin për dhënien dhe marrjen e dokumenteve gjyqësorë për shfrytëzim, të cilat ndodhen në vend-ruajtje për vitin 2022, sipas kërkesave të *“Normave Tekniko-Profesionale dhe Metodologjike në Republikën e Shqipërisë”* si dhe Vendimit nr.4, datë 19.06.2017 të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave.

Njëkohësisht u hartua dhe një program kompjuterik për evidentimin në mënyrë paralele të dokumenteve gjyqësorë në formën e arkivës së numerizuar, si një nga mjetet më efektive për shërbimin e dosjeve gjyqësore në një kohë sa më të shpejtë por dhe si një masë e shtuar për mbrojtjen e regjistrave nga dëmtimet e mundshme për shkak të përdorimit të shpeshtë të tyre.

Në lidhje me dërgimin e dosjeve gjyqësore dhe lëshimin e fotokopjeve të dokumenteve të cilat gjenden në fondin arkivor të gjykatës, i është kthyer përgjigje, duke respektuar afatet proceduriale, kërkesave të adresuara gjykatës, nga institucionet shtetërore dhe joshtetërore, personat e interesuar, avokatët, të cilat janë të evidentuara në regjistrin e dhënies dhe marrjes së dokumenteve nga vendruajtja.

Pas përpunimit dhe sistemimit të dokumentacionit të trashëguar prej dy viteve (2020-2021), si dhe mbi bazën e rekomandimeve/udhëzimeve dhe detyrave të lëna nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, mbi gjendjen e dokumenteve dhe arkivit në institucionin tonë, filloi puna për vënien në zbatim të masave administrative të kërkuara nga ana e tyre. “Komisioni i ekspertizës” i kësaj gjykate hartoi listën konkrete me afatet e ruajtjes së dokumentave për GJKKO-në. Filloi puna në lidhje me përpunimin tekniko-shkencor të dokumenteve me afat ruajtje të përhershëm si dhe dokumenteve me afat ruajtje të përkohshëm sipas “Listës tip”. Dorëzimi i dosjeve të përpunuara nga specialisti i sekretari-arkivit në Arkivin Shtetëror të Sistemit Gjyqësor, nuk u bë i mundur për shkak të ndryshimeve të reja ligjore në lidhje me listën tip me afatet e ruajtjes së dokumentacionit arkivor në gjykata, të cilat priteshin të miratoheshin nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Gjithashtu, në përgjigje të shkresës së dërguar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për mendim mbi draft-rregulloren për asgjësimin e dokumentacionit arkivor në gjykata, është përgatitur dhe dërguar informacioni i kërkuar së bashku me “Listën tip” me afatet e ruajtjes dhe asgjësimit të dokumentacionit arkivor, e cila do të duhej të miratohej nga ana jonë pasi të merrej vendimi përfundimtar nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor, në lidhje me miratimin e kësaj liste. Po ashtu në përgjigje të shkresës së dërguar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor në bashkëpunim me kryesekretarinë e gjykatës, është përgatitur informacioni mbi inventarin e dokumentacionit arkivor, i cili administrohet nga gjykata.

Ndodhur në këto kushte, si dhe me hyrjen në fuqi të Urdhërit nr.46, datë 15.06.2022 të Drejtorit të Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor për *“Miratimin e Rregullores mbi Metodikën dhe Tipologjinë e Menaxhimit të Arkivës Gjyqësore”*, nga ana e zyrës së sekretari-arkivit është bërë i mundur inventarizimi i vendimeve penale për vitet 2004-2011, si dhe përpunimi tekniko-shkencor i dosjeve gjyqësore të çështjeve penale themeli për vitet 2004-2006 sipas të gjitha kriterëve të përcaktuara në legjislacionin arkivor dhe janë të gatshme për tu dorëzuar në Arkivin Shtetëror të Sistemit Gjyqësor. Me vendimin nr.426, datë 14.10.2022, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur: *“Miratimin e listës tip me afatet e ruajtjes së dokumenteve gjyqësore që arkivohen në gjykata”*. Sipas aneksit 7 të këtij Vendimi përcaktohet se: *“Fondi arkivor i ish Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda do të ruhet në mënyrë të përhershme dhe nuk do t’i nënshtrohet procesit të asgjësimit.”*

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, i gjithë fondi arkivor i ish Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda do të përpunohet sipas kriterëve arkivore për dokumentet me *“Rëndësi Historike Kombëtare”*, duke përfshirë edhe ato dosje të cilat ishin të përcaktuara me afat ruajtje të përkohshëm. Këto kriterë janë detyruese edhe përsa i përket procedurës së dorëzimit pranë Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor.

Ndodhur në këto rrethana, si dhe faktit se ky fond arkivor për shkak të natyrës së çështjeve të cilat gjykohen nga kjo gjykatë, ka në përbërje të tij një numër të lartë të dokumentacionit arkivor gjyqësor (të volumeve të dosjeve gjyqësore dhe fashikujve hetimorë), të cilat duhet të përpunohen nga ana tekniko-shkencore sipas kriterëve të përcaktuara në legjislacionin arkivor, nga ana jonë është kërkuar edhe punonjës shtesë me emërim të përkohshëm pranë zyrës së sekretari-arkivit për të ndihmuar në lidhje me realizimin e këtij procesi inventarizimi si dhe në kuadër të projektit të Këshillit të Lartë Gjyqësor për dixhitalizimin e arkivave të gjykatave, të cilët aktualisht janë efektivë, pasi KLGJ ka miratuar kërkesën e bërë nga ana jonë, për punësimin e tyre me kohë të pjesshme pranë kësaj gjykate, në funksion të realizimit eficient të qëllimit më sipër.

Me hyrjen në fuqi të Urdhërit nr.46, datë 15.06.2022 të Drejtorit të Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor për *“Miratimin e Rregullores mbi Metodikën dhe Tipologjinë e Menaxhimit të Arkivës Gjyqësore”* dhe Vendimit nr.426, datë 14.10.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor për *“Miratimin e listës tip me afatet e ruajtjes së dokumenteve gjyqësore që arkivohen në gjykata”*, në lidhje me

realizimin e objektivave gjatë vitit 2023, duke qenë se kuadri ligjor tashmë është i plotë do të merren masat e duhura për :

- Inventarizimin e plotë të dokumentacionit gjyqësor/administrativ,
- Përpunimin tekniko-shkencor të dokumentacionit arkivor,
- Transferimin e dosjeve gjyqësore pranë Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor,
- Përmirësimin e kushteve të vendruajtjes në funksion të mirë administrimit të dokumentave gjyqësorë për të mos pasur dëmtime të materialit arkivor deri në përdorshmëri të tij.

Gjithashtu gjatë vitit 2023 nevojitet trajnimi nga ana profesionale i specialistit të arkivës nëpërmjet trajnimeve të cilat zhvillohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, Shkolla e Magjistraturës si dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

Në zbatim të parimeve bazë të punës arkivore, përparësi do të marrë kursimi i kohës dhe përmirësimi i mjeteve për gjetjen në kohë sa më të shpejtë të informacionit arkivor si dhe duke mbajtur parasysh përmirësimin e shfrytëzimit dhe shërbimit të dokumentacionit gjyqësor të kërkuar nga ana e subjekteve shtetërore dhe joshtetërore, avokatëve, personelit të gjykatës apo personave të interesuar.

7. Zyra e Buxhetit dhe Financës

Zyra e Financës së GJKKO-së përbëhet nga Kryetari i Degës së Buxhetit dhe specialisti i financës. Detyrat e këtij sektori janë të përcaktuara shprehimisht në nenin 41/b, të ligjit nr. 98, datë 06.10.2016 *“Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”* e sipas nenit 45 të ligjit të sipërcituar, parashikohet se *“Shërbimi financiar ushtron dhe zbaton detyrimet që rrjedhin nga ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligji 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin dhe kontrollin financiar”, i ndryshuar, si dhe aktet në zbatim të tyre. Kjo zyrë është përgjegjëse për hartimin e Raportit Financiar për vitin 2022.*

7.1. Raporti Financiar për Vitin 2022

Më poshtë parqiten disa nga treguesit kryesorë të realizimit të planit buxhetor për vitin 2022.

Plani i buxhetit me gjithë ndryshimet që ka pësuar gjatë vitit raportues paraqitet i realizuar si në tabelën e mëposhtme, i detajuar me artikujt përkatës dhe i shprehur në përqindje dhe në vlerë absolute:

Tabela: Plani i Buxhetit

Artikull	Emërtimi	Plani rishikuar gjatë vitit (12-mujori)	Fakti i realizimit 12 mujor	Diferenca ne vlere ne 000/leke	Realizimi ne %
600	Paga	96,000.00	93,536	2,464	97
601	Sigurime Shoqërore	9,750.00	9,746	4	100
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	17,400.00	17,400	0	100
606	Transferta per Buxhete Fam. & Individ	820.8	820.8	0	100
Nën-Totali	Shpenzime Korrente	123,971	121,503	2,468	98
230	Kapitale të Patrupëzuara	-	-	0	-
231	Kapitale të Trupëzuara	4,342.00	4,342	0	100
Nën - Totali	Shpenzime Kapitale	4,342.00	4,342	0	100
Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti		0	0	0	-
Totali (korrente + kapitale + Shp nga te ardh.jashtë limiti)		128,313	125,845	2,468	98

7.1.1. **Artikulli 600 + 601 (Paga dhe sigurime).** Plani për periudhën 12-mujore ka pësuar ndryshimet si më poshtë:

- Reduktuar Artikulli 600 me -4,000 mijë lekë,
- Reduktuar Artikulli 601 me -250 mijë lekë.

Pas ndryshimeve të pësuara gjatë vitit ushtrimor, realizimi i këtyre zërave të shpenzimeve të personelit, në fund të 12-mujorit, paraqitet në masën 97.66% .

Realizimi në këtë masë vjen për arsye të strukturës organike të miratuar të paplotësuar të gjykatës, kryesisht me gjyqtarë, si dhe ndryshimit të planit si më lart përshkruar.

Në fund të 12 mujorit struktura organike paraqitet: Plan 65 punonjës, fakt 55 punonjës (*7 gjyqtarë, *1 specialist i shërbimeve mbështetëse, *2 shoferë).

7.1.2. Artikulli 602. (Shpenzime operative; *Mallra dhe shërbime të tjera*).

Plani për periudhën 12-mujore ka pësuar ndryshime duke u reduktuar fillimisht në masën; - 3000 mijë lekë, sipas Aktit Normativ Nr 3 datë 13.02.2022 dhe duke u shtuar me + 700 mijë lekë nga rialokimi i këtij fondi në të njëjtën masë nga Artikulli 606 i cili u reduktua në masën -700 mijë, sipas kërkesës sonë për prokurimin e një sasie shtesë karburanti, për shkak të rritjes së cmimit të këtij produkti në treg.


Realizimi i këtij zëri shpenzimesh për periudhën raportuese është në masën 100%.

Tabela: Artikulli 602

Artikulli 602	Në vlerë	Në %
Materiale zyre e të përgjithshme	3,354,184.00	19.28
Shërbime nga të tretë	6,457,489.00	37.11
Shpenzime transporti	3,408,034.00	19.59
Shpenzime udhëtimi	552,170.00	3.17
Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	1,462,580.00	8.41
Shpenzime të tjera operative	2,165,116	12.44
Total: <i>Mallra dhe shërbime të tjera</i>	17,399,573	100

Në vijim, paraqitet grafiku i përqindjes (%) që zënë zërat e shpenzimeve operative analitike në realizimin faktik total të shpenzimeve operative për vitin 2022.

Përqindja që zënë zërat e shpenzimeve operative analitike në realizimin faktik total të shpenzimeve operative për vitin 2022



- Materiale zyre e të përgjithshme
- Shërbime nga të tretë
- Shpenzime transporti
- Shpenzime udhëtimi
- Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme
- Shpenzime të tjera operative

Sikurse vihet re nga grafiku i sipërcituar, pjesën kryesore të shpenzimeve e zënë **shpenzimet për shërbime** si, ato për energji elektrike, ujë, shpenzime postare, shpenzime telefonike dhe celulare, të cilat zënë **37.1%** të tyre.

Shpenzimet e transportit për blerje karburant, pjesë këmbimi, goma, bateri dhe mirëmbajtje mjete transporti, paraqiten në masën **19.59%**.

Shpenzimet për blerje materiale të ndryshme si, letër, kancelari materiale pastrimi, lëndë djegëse kaldaje, gjenerator, abonime, etj., në masën **19.28%** e tyre.

Shpenzimet për pagesë avokatësh, ekspertësh psikologësh dhe përkthyesish, taksa, tatime, etj., paraqiten në masën **12.4%**.

Shpenzimet e mirëmbajtjes së zakonshme për godinën, systemin e ngrohjes dhe të ftohjes, mirëmbajtje elektrike teknike dhe elektronike, zënë **8.41%** të shpenzimeve faktike vjetore.

Shpenzime udhëtimi në masën **3.17%** të tyre paraqesin shpenzimet për udhëtim jashtë vendit të gjyqtarëve të kësaj gjykate në kuadër të takimeve për shqyrtimin e Kapitullit 23 “*Gjyqësori dhe të drejtat themelore*”, në Komisionin Evropian.

7.1.3. Artikulli 606 (Transferta për Buxhetorë Fam. & Individ).

Gjatë periudhës 12 mujore plani në këtë zë ka pësuar ndryshime, konkretisht i shtuar në masën +820.8 mijë lekë nga plani në fillimit të vitit dhe është përdorur plotësisht nga ana jonë si më poshte:

1. 90,800 leke përfaqëson dhënien e ndihmës ekonomike për dy punonjëse të dala në pension
2. 30,000 leke përfaqëson dhënien e ndihmës ekonomike për një punonjës të sëmurë.
3. 700,000 lekë përfaqëson mbështetjen ekonomike të dhënë nga qeveria për përballimin e situatës së rritjes së çmimeve në vend në fund të vitit 2022.

Realizimi i këtij zëri shpenzimesh për periudhën raportuese është në masën 100%.

7.1.4. Artikulli 231: (Investime)

Plani për periudhën raportuese paraqitet i ndryshuar dhe konkretisht :

- a) Shtuar në masën + 600 mijë lekë, dhe
- b) Pakësuar në masën -268 mijë lekë .

Ky zë për 12-mujorin paraqitet me një realizim në masën 100%. dhe me fondet e akorduara janë prokuruar sipas prioriteteve disa pajisje të cilat do ti shërbejnë institucionit tonë për rritjen e performancës, sigurisë dhe transparencës së proceseve gjyqësore.

Tabela: Projekte të realizuara në zërin e shpenzimit “Investime”

Emertimi i pajisjeve të blera	Vlera (000/leke)
Mobilje zyre karrige lekure levizese 10 cope	228
Kondicionere 12BTU (vendqendrim roje godine 2)	96
Pajisje sigurie sistem Fikese zjarri per arkive	1,140
Pajisje te tjera Bllokues magnetik dyersh	143
Pajisje te tjera Module kontrolli LC8100 SILON	206
Pompe zhytесе ujerave te zeza	300
Barriere bllokuese hyrje godine me telekomandim	90
Pajisje ashensorë	867
Kompjuter, laptop	1272
Totali në vlerë	4,342

Në nivel krahasues buxheti i GJKKO-së në 3 vitet e fundit, paraqitet si më poshtë:

Tabela: Buxheti i GJKKO për 3 vitet e fundit.

Nr.	Emërtimi i Zërave Buxhetore	2020			2021			2022		
		Plan	Fakt	Në %	Plan	Fakt	Në %	Plan	Fakt	Në %
1	Investime	9250000	8808167	95.2	6870000	5541600	80.7	4342000	4342000	100
2	Paga, Shpërbime, Shpenzime të tjera Personeli	80000000	79621644	99.5	83000000	80397650	96.9	96000000	93536091	97
3	Kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore	7900000	7566733	95.8	10000000	8656078	86.6	9750000	9746486	100
4	Mallra dhe shërbime te tjera (Total 4.1 /4.2 / 4.3 /4.4 /4.5 /4.6)	18296000	17310607	94.6	18520000	15624518	84.4	17400000	17399573	100
4.1	Materiale e shërbime zyre	3816900	3416089	89.5	3668000	2586242	71	3537000	3354184	95
4.2	Shërbime	5198120	4581411	88.1	5962000	6277400	105	6100000	6457489	106
4.3	Shpenzime transporti	33379500	3712412	11.1	3440000	2327636	68	3683000	3408034	93
4.4	Shpenzime udhëtimi	42000	46000	110	50000	1000	2	200000	552170	276
4.5	Shpenzime mirembajtje të zakonshme	2341080	2187840	93.5	2008000	1438482	72	1980000	1462580	74
4.6	Shpenzime të tjera operative	3560000	3366855	94.6	3392000	2993758	88	1900000	2165116	114
5	Transferata për buxhete familjare dhe individë	0	0	0	568500	88500	15.6	820800	820800	100
Total		115446000	113307151	98.1	118958500	110308346	92.7	128312800	125844950	98.08

Prokurimet e realizuara për shpenzime operative dhe investime janë të pasqyruara hollësisht dhe të detajuara si në tabelë

Tabela: Prokurimet e realizuara për shpenzime operative dhe investime

Nr.	Përshkrimi	Fondi Limit	Fondi limit me TVSH	Vlera e kontratës	Vlera e kontratës me tvsh	Operatori ekonomik fitues	Periudha e zhvillimit
1	Pajisje elektronike Komputera Laptop	1060000	1272000	1060000	1272000	P C STORE	18-07-22
2	Kondicionere (vendqendrim roje godine)	80000	96000	80000	96000	Ervin Corbaxhi	1/6/2022
3	Pajisje te tjera Module kontrolli LC 8100 SILON	172000	206400	172000	206400	Herjol Xhagolli	28/04/2022
4	Pajisje te tjera Bllokues magnetik dyersh	119000	142800	119000	142800	CSP	5/12/2022
5	Pajisje te tjera - Pompe zhytese per ujra te zeza	250000	300000	250000	300000	BENNETT	29/04/2022
6	Mobilje zyre karrige lekure levizese etj.	190000	228000	190000	228000	R CEKA &CO	26/07/2022
7	Pajisje sigurie Sistem fikesë zjarri per arkive	950000	1140000	950000	1140000	CSP	25/03/2022
8	Pajisje te tjera Barriere bllokuese me telekomandim	74833	89800	74833	89800	EKM Konstrusion &Tecnologji	22/12/2022
9	Blerje pajisje te tjera (motore e inverter ashensori)	722500	867000	722500	867000	CLASS ASHENSOR	17/11/2022
10	Blerje bileta transporti ajror ndërkombëtar	200000	240000	124422	149306	TRAVEL&TOURS,	18/11/2022
				32450	38940	KELVIN TRAVEL	15/09/2022
11	Tonera	50000	60000	49800	59760	AICOM	21/12/2022
12	Abonime (fletore zyrtare)	20000	24000	20000	20000	Posta Shqiptare SHA	9/2/2022
				39200	47040	F.L.E.SH.	29/03/2022
13	Shtypshkrime	200000	240000	27000	32400	DHIMITER VASI	4/10/2022
				94300	113160	F.L.E.SH.	14/12/2022

14	Uniforma (Pelerina)	100000	120000	90000	108000	Gentian Sadiku	22/12/2022
15	Leter A4, A3	750000	900000	327750	393300	INTERLOGISTIC	9/3/2022
				269230	323076	Infosoft Office	14/09/2022
				169780	203736	V Osmani	13/05/2022
16	Materiale Pastrimi ,dezinfektimi anticovid,	250000	300000	75700	90840	HEP-2012	18/11/2022
17	Kancelari	200000	240000	165000	198000	Infosoft Office	28/02/2022
				24167	29001	ELDI Qafmolla	15/11/2022
18	Furnizime me materiale te tjera te pergjithshme	100000	120000	21500	21500	Armalind Rrokaj	2/10/2022
				35100	35100	Armalind Rrokaj	26/04/2022
				29200	35040	Sokol Rrokaj	28/12/2022
19	Blerje karburanti /vaji	2500000	3000000	411777	494132.4	A&T SHA	9/3/2022
				857451	1028941.2	A&T SHA	9/3/2022
				1158927	1390712.4	A&T SHA	15/03/2022
20	Blerje karburanti /vaji	1000000	1200000	400000	480000	EUROPETROL TRAVEL DURRES AL	24/11/2022
				160200	192240	EUROPETROL TRAVEL DURRES AL	24/11/2022
				26667	32000	CLASSIC	4/3/2022
				12500	15000	BRILLIANT LINE	4/3/2022
				37890	45468	NOSHI	15/03/2022
				17500	21000	BENNETT	25/03/2022
				11833	14199	CLASSIC	17/05/2022
21	Pjese Këmbimi Goma,Bateri	700000	840000	48800	58560	BILURBINA	23/09/2022
				18000	21600	CLASSIC	20/09/2022
				11833	14200	CLASSIC	17/10/2022
				53633	64360	CLASSIC	6/9/2022
				13000	15600	BENNETT	17/10/2022
				40000	48000	TETEA	11/11/2022
				80000	96000	TETEA	1/12/2022
22	Sherbim interneti	75000	90000	60000	72000	VODAFONE ALBANIA	1/2/2022
23	Sherbime te tjera transporti(Lavazh Automjetesh)	250000	300000	148000	177600	Xhovan Gjini	26/01/2022
24	Sherbime te printimit dhe publikimit	1000000	1200000	793000	951600	AICOM	1/2/2022
				179600	215520	AICOM	13/10/2022

25	Mirembajtje Pajisje elektronike& sist bms	150000	180000	124000	148800	Inside System Touch	20/12/2022
26	Sherbim Mirembajtje mjete transporti	100000	120000	29870	35844	TETEA	16/02/2022
				13000	13000	Telia Kurti	28/07/2022
				12000	12000	Gezim Shala	23/09/2022
				9000	10800	BENNETT	19/10/2022
27	Sherbim i siguracioneve të mjeteve të transportit	380000	456000	218500	218500	INSIG SHA	5/5/2022
				116786	116786	INSIG SHA	18/02/2022
				138000	165600	5 XH GROUP,BENNETT	5/4/2022
28	Mirembajtje rrjeteve hidraulike ,elektrike , teknike (ashensore, kaldaje siguri, gjenerator, telefon, qender zeri, Mkz)	1000000	1200000	48700	58440	FORSITEK	6/4/2022
				42000	50400	GEAM SHPK	10/5/2022
				17500	21000	A BALUKJA	15/07/2022
				21800	26160	BENNETT	25/07/2022
				340000	408000	CSP	5/12/2022
				22000	26400	BENNETT	28/10/2022
29	Mirembajtje lulishte	100000	120000	30000	30000	Telia Kurti	1/3/2022
				39250	47100	V Gjoshe	12/9/2022
30	Mirembajtje Godine (Lyerje, riparim dyer dritare pllaka)	400000	480000	38400	46080	MURATI BA	7/4/2022
				28500	34200	UNIVERSAL	1/6/2022
				35000	42000	Cela Group	13/07/2022
31	Sherbim i siguracioneve ndertesave dhe te tjera kosto sig .te ngjashme (licensim konstruksioni metalik I godines +Sigurim ndertese nga permbytjet)	250000	300000	-	-	-	-
32	Te tjera materiale dhe sherbime speciale (te personalizuar)	100000	120000	25000	25000	B Topi	15/02/2022
				9200	9200	F Lami	15/03/2022
				6000	7200	BENNETT	1/4/2022
				50000	60000	Tufik Kurti	18/07/2022



Analiza vjetore e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

33	Blerje inventari i imet	100000	120000	47650	57180	Vjollca Osmani	21/11/2022
34	Mirembajtje faqe WEB	400000	480000	398000	477600	ARK IT	23/02/2022
Total		13993333	16792000	11613699	13836222	-	-

Të ardhura të realizuara nga institucioni për vitin 2022 paraqiten të detajuara në pasqyren e mëposhtme.

Tabela: Të ardhura të realizuara nga institucioni për vitin 2022

Artikulli	Emertimi	12- MUJORI 2022
7081006	Taksa e Akteve dhe të Pullës (10% i të ardhurave nga pullat)	13,420
7115401	Gjoha gjyqesore	163,470
7111008	Të ardhura nga fotokopja	529,930
	<i>Shuma e kl.7</i>	<i>706820</i>
4665100	90% i të ardhurave nga pullat	120,780
4665100	90% i të ardhurave nga 1%	0
	<i>Shuma e kl. 4</i>	<i>120780</i>
TOTALI		827600

Të ardhurat e realizuara nga gjykata referuar tre viteve të fundit krahasues, kanë një trend rritës. Kështu të ardhurat e realizuara nga gjykata referuar vitit 2021, të cilat ishin në masën 633,870 leke, janë rritur në 706820 lekë ose 10.6%. më shumë. Këto të ardhura janë derdhur plotësisht në buxhetin e shtetit.

Tabela: Të ardhurat për vitet 2020-2022

Të ardhura dytësore që kalojnë nëpërmjet degës të thesarit					
Artikulli	Emërtimi	2020	2021	2022	
7081006	Taksa e Akteve dhe e Pulles (10% i te ardhura nga pullat)	10,080	12,000	13,420	
Klasa 7	7115401 Gjoha gjyqesore	15,000	20,000	163,470	
	7111008 Te ardhura nga fotokopja	84,230	606,870	529,930	
	<i>Shuma e kl.7</i>	<i>109310</i>	<i>638870</i>	<i>706,820</i>	

Klasa 4	4665100	90% i të ardhurave nga pullat	90,720	108,000	120,780
		Shuma e kl 4	90720	108000	120780
TOTALI (Klasa 7 dhe 4)			200030	746870	827,600

7.2. Analiza e e gjetjeve të auditimit të kryer gjatë viti 2022, për periudhën 2020-2021.

GJKKO-ja ka qenë objekt auditimi nga Kontrolli i Lartë i Shtetit gjatë vitit 2022, ku objekt kontrolli ka qenë veprimtaria e saj për periudhën: nga data 01.01.2020 deri më datën 31.12.2021. Nga kontrolli i ushtruar nga KLSH “Mbi shkallën e zbatueshmërisë nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, bazuar në procedurat e kryera dhe evidencën e përfutur, u evidentua në përgjithësi zbatimi i tyre dhe po kështu nuk janë evidentuar raste mospërpjethjesh materiale për të raportuar. **Audituesit nën gjykimin tyre profesional e të pavarur dhanë një “opinion të pakualifikuar”, i cili në termat e vlerësimit të tyre, do të thotë vlerësim pozitiv, ku nuk rezultojnë devijime materiale.**

U audituan Pasqyrat financiare të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të datës 31.12.2020 dhe 31.12.2021, të cilat përbëhen nga: Pasqyra e pozicionit financiar; Pasqyra e performancës financiare; Pasqyra e flukseve monetare; Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto; Pyetëtori dhe shënimet shpjeguese dhe si pasqyra me anekset statistikore të cilat përfshijnë: Pasqyrën e investimeve dhe burimet e financimit; Pasqyrën mbi gjendjen dhe ndryshimet në aktivet afatgjata (Kosto Historike); Pasqyrën gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me konston historike dhe me vlerën neto; si dhe Pasqyrën mbi numrin e punonjësve dhe fondin e pagave.

Opinionit i audituesve dërguar me raportin perfundimtar për pasqyrat financiare dhe zbatimin e buxhetit të shtetit ishte se “veprimet përgjatë raportimit financiar dhe transaksionet e kryera për ekzekutimin e buxhetit, janë në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi (ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, si dhe me ligjet dhe rregullat përkatëse të financave publike). Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur baza të pranueshme të kontabilitetit dhe politika të cilat janë aplikuar në vazhdimësi si dhe janë paraqitur saktë të gjitha çështjet materiale që lidhen me pasqyrat financiare. Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, pasqyrat financiare të subjektit “Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të subjektit në datën 31.12.2021 dhe rezultatet e operacioneve të tyre dhe të flukseve monetare për vitin e përfunduar, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për raportimin financiar. Gjithashtu ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e Opinionit të pakualifikuar¹ (me theksim çështje -pronësia e godinës).

Në përfundim të aktivitetit të kontrollit , në raportin përfundimtar të dërguar nga KLSH , janë lënë disa rekomandime të cilat duhet të kihen parasysh në veprimtarinë e mëtejshme të institucionit. Nga ana e jonë është hartuar, miratuar, dhe ka filluar zbatimin e Planit të Punës për Zbatimin e Rekomandimeve të Auditit të KLSH-së:

Rekomandimi nr.1: *“Nga ana e GJKK.O-së të merren masa për ndërtimin e saktë të pasqyrave financiare dhe formateve shoqëruese, duke mbajtur në konsideratë Udhëzimet standarte të përgatitjes së PF. Tepëricat në çelje dhe në mbyllje të llogarive respektive të aktiveve duhet detyruesisht të jenë të rakorduara me të dhënat e këtyre llogarive të pasqyruara në grupin A të pasivit të bilancit kontabël. Ndërtim dhe paraqitje e saktë e mënyrës së pasqyrit të formatit nr. 7 "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata”.*

E zbatuar. Hartuesi i pasqyrave financiare ka sistemuar tabelat statistikore 7b me veprimet saktësuese për vitet 2020 dhe 2021 dhe i ka dërguar pranë KLSH me observacionet e dërguara (Meqenese keto veprime janë saktësime nga ana formale e paraqitjes së tyre në tabelën e cituar dhe nuk kanë ndikim në vlerat e paraqitura në pozicionin financiar të janë printuar dhe zëvendësuar në pasqyrat financiare ekzistuese) Gjithashtu janë marrë masa për paraqitjen e saktë të të dhënave statistikore në Tabelën 7b të pasqyrave financiare për vitin 2022 dhe në vijim në mënyre që tepëricat në çelje dhe në mbyllje të llogarive respektive të rakordojnë me pozicionin financiar të bilancit.

Rekomandimi nr.2: *Nga ana e GJKK.O-së të merren masa për ndërtimin e saktë të pasqyrave financiare dhe formateve shoqëruese, duke mbajtur në konsideratë Udhëzimet standarte të përgatitjes së PF në lidhje me Llogarinë 532 "Vlera të tjera" Funksionimi i llogarisë 532 të realizohet duke kredituar klasën 7 "Të ardhura nga diferenca çmimit" dhe debituar llogarinë 468 "Debitorë të ndryshëm”.*

Dakort me zbatimin. Hartuesi i pasqyrave financiare po rishikon kontabilizimin e llogarisë 532 sipas rekomandimit të auditit dhe sipas procedurave të unifikuara dhe veçorive e praktikave të ndjekura nga sistemi gjyqësor, si dhe do të japë shpjegime më të thelluara të kësaj llogarie, të evidentueshme dhe të kuptueshme nga audituesi, në tabelat e pasqyrave financiare të vitit 2022.

Rekomandimi nr.3: *Nga ana e GJKKO-së në bashkëpunim me MD, të kryhen procedurat për marrjen e dokumentit të dhënies së dakortësisë nga NJQQ për kalimin e përgjegjësisë së operimit/menaxhimit tek GJKKO;*

-Nga ana e GJKKO-së dhe MD të merren masat për pasqyrimin kontabël të aktiveve afatgjata, në përdorim nga të dy institucionet në përputhje me procedurat e përgatitjes, paraqitjes, dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Në proes zbatimi. Pasi ka vijuar korespondenca me anë të shkresës së dërguar së fundmi Nr. 529 prot., datë 20.02.2023 me Ministrinë e Drejtësisë për marrjen e dokumentit nga kjo ministri, në

statusin e Njesisë Qëndrore të Qeverisjes, të dakortësisë për kalimin e përgjegjësisë së operimit/menaxhimit, të institucioni ynë. Dega e buxhetit në bazë të dokumentave zyrtare që do të sigurojë si dhe atyre që zotëron deri tani, do të rishikojë pasqyrimin e këtij aktivi në pasqyrat financiare, në përputhje me bazen ligjore tatimore në fuqi.

Rekomandimi nr.4: *Nga ana e GJKKO-së të merren masa që, në çdo rast, praktikave të Urdhërshpenzimeve t'u bashkëngjiten procesverbalet përkatëse, në cilësinë e dokumentacionit vërtetues pasi në dy raste mungon bashkëlidhur dokumentacioni i plotë dhe i nevojshëm për urdhërshpenzimin.*

E Zbatuar dhe në zbatim në vijimësi. Janë bashkangjitur në praktikat bankare të likuidimit të prokurimeve me blerje të vogla në formë shkresore dhe urdhëri për krijimin e komisionit të blerjeve të vogla i cili del njëherë në fillim të vitit dhe është i vlefshëm për të gjitha prokurimet me blerje të vogla, por dhe në procedura për të cilat nuk është cilësuar komisioni i realizimit të blerjeve.

Do të vlerësohet me një proces verbal të veçantë dhe do të bashkangjitet në praktikat e likuidimit, në cilësinë e dokumentit justifikues, proces verbali i përshkrimit të punës së ekspertëve të jashtëm të kontraktuar, por gjatë vitit raportues nuk kemi patur.

Rekomandimi nr.5: *Nga ana e GJKKO të merren masat për rakordimin dhe unifikimin i vlerave të paraqitura në pasqyrat financiare me vlerat e paraqitura në aktet e rakordimit me degën e thesarit.*

-Të hartohet dhe nënshkruhen rregullisht situacionet mujore, periodike dhe vjetore për shpenzimet e ushtrimit nga veprimtaria e GJKKO dhe për çdo mospërputhje të të dhënave të pasqyrave financiare që shoqërojnë bilancin kontabël, të jepen shpjegimet sqaruese për çdo rast.

E Zbatuar. Megjithëse nga ana jonë janë kryer rregullisht rakordimet mujore periodike, si për shpenzimet ashtu dhe për të ardhurat, pasi jemi njësi varësie dhe raportojmë periodikisht në KLGJ ,si në formë elektronike ashtu dhe në formë shkresore. Kemi vijuar dhe do të vijojmë ta kryejmë këtë proces me rigorozitet. Po kështu do jepen shpjegime më të thelluara në lidhje me shifrat e situacionit të rakorduara me thesarin, dhe pasyrimin e tyre në pasqyrat financiare në pasqyrën e shënimeve shpjeguese të PF të vitit 2022, pasi si rrjedhojë e përdorimit të parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, sipas UMF nr. 8, dt. 09.03.2018, përdoruesit e PF duhet të jenë më të qartë.

Rekomandimi nr.6: *Nga ana e GJKKO-së të merren masa për hartimin e pasqyrave financiare dhe formateve shoqërues në përputhje me për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në NJQP pasi në Formatin nr. 6 “Investimet dhe Burimet e financimit” u konstatua se, “Teprica në mbyllje” nuk rakordon me shumën që figuron në postin*

përkatës të llogarive financiare (520) për ushtrimin e mbyllur në aktiv të bilancit per vlerën e 5% te garancisë së punimeve.

Dakort me zbatimin. Por për vitin 2022 nuk kemi garanci bankare të cilat pasqyrohen në Formatin nr. 6 “Investimet dhe Burimet e financimit”. Do të pasqyrohet çelja në fillim të vitit për ato projekte investimesh apo, rikonstruksione të cilat janë projekte shumëvjeçare ose kanë garanci punimesh për periudhat raportuese në vijim.

Rekomandimi nr.7: *Nga ana e GJKKO-së të merren masa që, regjistri i aktiveve përveç hartimit të tij sipas llojit të aktiveve afatgjatë apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit, të përmirësohet dhe plotësohet me aspekte të tjera, me kërkesat minimale që duhet të përmbajë regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, që lidhen me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.*

Në zbatim e sipër. Po përmirësohet dhe po plotësohet libri i AQT-ve me: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit e gjendjes së aktivit , vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, datën e daljes nga pronësia etj.

Rekomandimi nr.8: *Autoriteti Kontraktor (grupi i punës, njësia e prokurimit apo komisioni përkatës), në procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, duhet të argumentojë teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter të vendosur në përputhje me natyrën e kontratës duke i dokumentuar ato në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.*

Në zbatim e sipër. Njesia e prokurimit ose personat e ngarkuar sipas rastit, po argumentojnë teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter të vendosur në përputhje me natyrën e kontratës duke i dokumentuar ato në një procesverbal të mbajtur nga ato.

Rekomandimi nr.9: *Autoriteti Kontraktor (personi përgjegjës për prokurimin) të marrë masa për inventarizimin e të gjithë dokumentacionit në lidhje me procedurat e sipërcituara, duke dokumentuar të gjithë procesin në rend kronologjik, sikurse kërkohet nga normat tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në RSH.*

Në zbatim e sipër. Personi përgjegjës për prokurimin ka kryer inventarizimin e dosjeve dhe vazhdon ta kryejë në vijimësi, si dhe kryen arkivimin e tyre, sipas normave të shërbimit arkivor në RSH.

Rekomandimi nr.10: *Autoriteti Kontraktor (grupi i punës, njësia e prokurimit apo komisioni përkatës), në rastin e procedurave me objekt furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët, ky i fundit, si kriter për shpalljen e ofertës fituese, të përllogaritet bazuar në: a) çmimin e bursës, lëvruar sipas kushtit CIP-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim çdo javë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në Buletinin e Njoftimeve Publike; b) elementet fiskale; c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës.*

Duke u zbatuar. Grupi i punës, njësia e prokurimit dhe KVO në rastin e procedurave në prokurimet me objekt furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje të kriterin për shpalljen e ofertës fituese, ka përllogaritur fondin duke u bazuar në:

- a) çmimin e bursës, lëvruar sipas kushtit CIP-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim çdo javë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në Buletinin e Njoftimeve Publike;
- b) elementet fiskale;
- c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës.

Rekomandimi nr.11: *Autoriteti Kontraktor (personi përgjegjës për prokurimin) të marrë masa për të siguruar një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit. Personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave.*

E zbatuar. Aktualisht me përmirësimin dhe plotësimin e strukturës organike të institucionit është plotësisht e mundur dhe po ndiqet me përparësi rekomandimi për një ndarje sa më të qartë të detyrave në proceset e prokurimeve me vlera të mëdha, për të shmangur me çdo kusht pjesmarrjen e të njëjtit person në dy komisione. Po kështu kemi përfshirë në komisionet e prokurimit dhe një IT të Gjykatës së Posaçme të Apelit.

Rekomandimi nr.12: *Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të vlerësojë të vlefshme dhe të kualifikojë një ofertë vetëm kur ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe dokumentet e tenderit që autoriteti kontraktor ka vlerësuar të nevojshme.*

Dakort me zbatimin. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave do të shmangë çdo devijim sado i vogël të jetë, dhe do të vlerësojë të vlefshme dhe të kualifikojë një ofertë vetëm kur ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe dokumentet e tenderit që autoriteti kontraktor ka vlerësuar të nevojshme si dhe do të dokumentojë në proces verbale të veçanta të gjitha sqarimet e ofertuesit mbi devijimet e vogla nëse do të merren parasysh.

Rekomandimi nr.13: *Njësia e prokurimit apo specialisti i fushës, në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kriterëve për kualifikim, duhet të argumentojë teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter të vendosur, duke përdorur vetëm ato kriterë të cilat janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.*

Dakort me zbatimin. Njësia e prokurimit dhe specialistët e fushës do të hartojnë kriterë të pjesëmarrjes të cilat të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, për të mos ndikuar negativisht në konkurrencën efektive midis operatorëve ekonomikë.

Rekomandimi nr.14: *-Autoriteti Kontraktor (Komisioni “Për Përllogaritjen e Fondit Limit”) për procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, paraprakisht të përgatisë specifikimet teknike në lidhje me objektin e prokurimit, në bazë të të cilave, më pas, të përcaktojë fondin limit të kontratës.*

- Autoriteti Kontraktor (grupi i punës, njësia e prokurimit apo specialisti i fushës, në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, në përcaktimin e specifikimeve teknike nuk duhet të ketë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë marke apo emër të veçantë, patentë, vizatim ose tip. AK, për sa është e mundur, duhet të aplikojë masa variabile të parametrave teknike në lidhje me objektin e kontratës, duke krijuar në këtë mënyrë kushte për konkurrim të paanshëm dhe efektivitet për konkurrencën në prokurimin publik.

E zbatuar. Komisioni i llogaritjes së fondit limit ka vepruar dhe do të veprojë në përputhje me ligjin e prokurimeve publike në fuqi duke përdorur në të gjitha rastet mënyrat e rekomanduara nga ky ligj, si studim tregu/kontrata të ngjashme etj.

Në llogaritjen e fondit limit komisioni ka disponuar fillimisht specifikimet teknike të përgatitura më parë nga grupi i punës apo specialisti i fushës, sipas urdheut të titullarit të institucionit. Ky komision apo specialist i fushës i janë referuar apo kanë përpiluar kërkesa pa ndonjë referencë të ndonjë marke, duke përdorur parametra variabile teknike duke bërë të mundur një konkurim të paanshëm në procedurat e prokurimeve.

Rekomandimi nr.15: *Gjykata e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të marrë masa për hartimin, propozimin për miratim të rregullores së brendshme, në përputhje me ndryshimet e deritanishme ligjore dhe strukturore që kanë patur efekt mbi organizimin dhe funksionimin e GJKKO si njësi publike, si dhe përditësimin e saj në vijimësi, në përputhje me ndryshimet përkatëse të kornizës ligjore.*

Në zbatim, në vijimësi. Rishikimi i Rregullores së Brendshme të GJKKO dhe pasqyrimi në këtë rregullore i ndryshimeve të ndodhura nga reforma në drejtësi si dhe e akteteve nënligjore të nxjerra

nga KLGJ, me qëllim mirëfunksionimin e institucioneve gjyqësore që ka në varësi, sikurse janë përshkrimi standard i punës, kurrikula për formimin profesional të nëpunësve civilë gjyqësorë, si dhe rregullat për treguesit e kriterëve që lidhen me kriteret e vlerësimit, burimet dhe procedurën e vlerësimit periodik të punonjësve, akte të cilat nuk rezultojnë të jenë miratuar deri në përfundim të periudhës së auditimit.

Me Vendimin e Këshillit të Gjykatës nr.22, datë 29.12.2022, është miratuar dhe ka hyrë në fuqi Rregullorja e Brendshme *“Për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Gjyqësore të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”*, si dhe *“Kodi i Etikës së Administratës Gjyqësore të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”*, akte këto të nxjerra në përputhje me ndryshimet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe me rëndësi të madhe në mbarëvajtjen e veprimtarisë së punës të punonjësve të administratës së GJKKO-së.

Është kryer njohja e personelit me këto akte si dhe detyrimi për zbatimin e tyre.

8. Zyra e IT-së.

Në organikën e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, janë 2 (dy) specialistë IT, të cilët mirëmbajnë, përditësojnë dhe instalojnë sistemet e mëposhtme:

- Sistemi ARK IT, CCMIS/ICMIS, sistemi për menaxhimin e informacionit të gjykatës.
- Sistemi RDA (FTR audio), sistemi për regjistrimin audio/video të seancave gjyqësore.
- Sistemi i ndërlidhjes në distancë për zhvillimin e seancave gjyqësore me persona jo të pranishëm, brenda apo jashtë vendit, ose në zbatim të masave të marra për shkak të gjendjes së krijuar nga pandemia e shkaktuar nga virusi Covid 19.
- Sistemi i informimit dhe publikimit të të dhënave për publikun.
- Sistemi kompjuterik për çdo përdorues
- Sistemi i printim/fotokopje
- Sistemi “CCTV”, për regjistrimin e pamjeve filmike të sigurisë fizike.
- Sistemi i skanimit dhe detektimit të hyrjes së personave të tretë.
- Sistemi i dhomës teknike.
- Sistemi i detektimit/shuarjes së zjarrit në ndërtesë dhe mjedise të posaçme.
- Sistemi i qendërzuar BMS i ndërtesës, dhe mjediseve të posaçme.
- Sistemi i telefonisë.
- Sistemi i aksesimit të sigurt në mjediset e ndërtesës.
- Ndërlidhja me Internet.
- Rrjeti kompjuterik.
- Sistemet Back-up.

Këto sisteme të instaluar dhe përditësuara ndër vite, nevojiten të monitorohen, përditësohen në vijimëmi, (Update/Upgrade) duke ruajtur dublikate me qëllim mirëmbajtjen e punës në momente kyçe (backup).

Më poshtë ju rendisim përshkrim të hollësishëm mbi secilin sistem, duke shfaqur gjendjen dhe ecurinë përgjatë vitit 2022.

8.1.Menaxhimi i çështjeve gjyqësore kryhet nëpërmjet Sistemit ARK IT.

Ky sistem u zhvillua dhe përditësua posaçërisht për gjykatën qysh në krijimin e saj, ish-Gjykata e Krimeve të Rënda. Me krijimin e GJKKO-së, sistemi u përshtat me nevojat e ndryshimeve të reja që pësoi legjislacioni në fushën e drejtësisë. Gjatë gjysmës së parë të vitit 2022, nuk u raportuan mangësi përse i përket ecurisë së sistemit. Në gjysmën e dytë të vitit u instalua versioni i përditësuar i tij, me modelin bashkëkohor klient-server, me ndërfaqe “web” dhe bazën e të dhënave të përditësuar.

Në këtë sistem u realizua importimi i të dhënave të gjykatës së mëparshme “Gjykata e Krimeve të Rënda” ashtu sikundër edhe çdo informacion tjetër i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Duke qenë sistem i ri, problematikat e para u raportuan duke u ndjekur hapa pas hapi në sistemin TTool të KLGJ-së deri në zgjidhjen përfundimtare të tyre. Përkatësisht janë raportuar ~115 (njëqind e pesëmbëdhjetë) detyra nga të cilat 105 (njëqind e pesë) prej tyre kanë gjetur zgjidhjen optimale.

Vlen të theksojmë faktin se sistemi i ri nuk bën akoma gjenrimin automatik të statistikave të gjykatës në lidhje me vendimet gjyqësore etj., të cilat sistemi i vjetër i kryente, gjë që sjell përpunimin manual të të dhënave dhe për rrjedhojë rrit kohën e punës për përpunimin e tyre dhe mund të sjellë gabime njerëzore në pasqyrimin e saktë të tyre. Kjo problematikë duhet të marri zgjidhje nga KLGJ-ja.

Ky sistem i përditësuar gjendet në kontratë mirëmbajtjeje nënshkruar nga KLGJ-ja dhe vijon të përditësohet apo zhvillohet sipas kërkesave të ndryshme të nevojshme.

8.2.Sistemi RDA (FTR Audio)

Ky sistem është mjaft i rëndësishëm për gjykatën pasi nëpërmjet tij realizohet regjistrimi audio për çdo seancë gjyqësore, duke siguruar transparencë në gjykim. Gjykata ka 5 (pesë) salla gjyqi dhe të gjitha sallat janë të pajisura me këtë sistem. Tek salla numër një, është mundur të regjistrohet edhe video krahas audios, duke realizuar monitorim tërësisht transparent të seancave gjyqësore.

Sistemi është konfiguruar për të kryer regjistrimin në vendndodhjen Ëork-station dhe të dhënat të kalojnë edhe në Server-in qendror të gjykatës. Ky konfigurim realizon jo vetëm mbrojtjen e të dhënave, por gjithashtu aksesimin paralelisht të tyre nga çdo njësi kompjuterike të ndërlidhur dhe

me akses në mjediset e gjykatës, duke lehtësuar punën e sekretareve gjyqësore, në plotësimin dhe zbardhjen e saktë të procesverbalit të seancës dhe gjyqtarëve në hartimin e vendimeve.

Gjithashtu nëpërmjet këtij sistemi realizohen kopje të seancave në CD/DVD për personat e tretë, si avokat apo palë, që kërkojnë të njihen me ecurinë e procesit. Ky sistem është i çertifikuar nga institucioni i KLGJ-së nënshkruar me kontratë mirëmbajtje të qëndërzuar nga kompania përkatëse.

Gjatë vitit 2022 me kërkesë të KLGJ-së u testua në mjediset e GJKKO-së sistemi i ri i përditësuar i RDA-së, si për sallat e gjyqit ashtu edhe për sekretaret gjyqësore. Testimi rezultoi i suksesshëm duke miratuar instalimin e tij në të gjithë gjykatat e Republikës së Shqipërisë.

8.3.Sistemi i komunikimit në distancë.

Në sallat e gjyqit të GJKKO-se janë instaluar 4 sisteme për komunikimin në distancë, të cilat në varësi të palës pritëse kanë protokolle kompjuterike të ndryshme duke realizuar video konferencë të enkriptuar jo vetëm për nevojat e gjykatës, por edhe gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm duke realizuar seanca marrjesh në pyetje dhe marrje dëshmish, për të pandehurit që jetojnë në shtete të tjera të BE-së, në kuadër të bashkëpunimit juridiksional me autoritetet e huaja.

Pjesë përbërëse e sistemit është edhe kërkesa për të vëzhguar pamje filmike, audio, foto digjitale, të provave materiale gjatë seancave gjyqësore. Në përmbushje të kësaj kërkesë janë vënë në dispozicion monitor të madhësisë 50” në 4 (katër) salla gjyqësore.

8.4.Sistemi i informimit dhe publikimit të të dhënave për publikun.

Sistemi i informimit dhe publikimit të të dhënave për publikun përbëhet nga faqja e internetit dhe kioska ndërvepruese (Touch-screen) me program të posaçëm për informimin e publikut, e cila gjendet në mjediset e publikut të GJKKO-së.

Nga raportet e hollësishme të mëposhtme, evidentohet se, gjatë vitin 2022 ka pasur ~550.000 aksesime të faqes së internetit, ku kërkesa më e lartë është tek Menu-të “*Urdhër thirrje për gjykim*”, “*Njoftime “Kalendari i Çështjeve”* dhe “*Njoftime për Shtyp*”.

Gjatë vitit 2022 u rinovua dhe plotësua me dokumentacionin e nevojshëm Menu-ja “Programi i Transparencës” sipas formatit të unifikuar për çdo institucion nga “Komisioneri për të drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale”.

Nga ana tjetër, në kioskën elektronike (Touch-screen), klikimet e përdoruesve të gjykatës kanë qënë aktive deri në muajin korrik të vitit 2022, pasi me implementimin e sistemit të ri kioska elektronike nuk ishte më funksionale. Është e rëndësishme zhvillimi dhe përditësimi i programit të ri, në mënyrë që të bëhet e mundur kthimi në gjendje pune i kioskës elektronike (Touch-screen), pasi përdoruesit e gjykatës nëpërmjet menuve “Orari sipas datave” dhe “Lista e Shortit”, marrin informacionin e kërkuar në lidhje me zhvillimin e proceseve të gjykimit.

Pjesë përbërëse e faqes së web-it ka qenë dhe menuja e statistikave të mënaxhimit të çështjeve gjyqësore të integruara automatikisht me sistemit ARK IT. Me implementimin e sistemit të përditësuar ARK IT, kjo menu nuk është më funksionale, si rrjedhojë orari i gjyqeve raportohet në mënyrë manuale vetëm për javën në vazhdim. Edhe lista e shortit është konvertuar në raportim manual. Informacionet e tjera, të tipit “detaje të çështjes”, “çështje në gjykim”, “kohëzgjatja e çështjes”, “informacion mbi seancën”, janë totalisht jashtë pune. Është detyrë e KLGJ-së (firmës së kontraktuar për rinovimin dhe mirëmbajtjen e programit), që të ofrojë një zgjidhje integrimi “API” në faqene e web-it për problematikën e sipërcituar.


Gjithashtu kërkesë e domosdoshme është zhvillimi i programit ARK IT, për të bërë të mundur anonimizimin e vendimeve gjyqësore të dhëna nga GJKKO.

Më poshtë janë tabelat përmbledhëse bashkë me grafikët e detajuar për secilën nga menu-të.


Tabela: Akses i faqes së internetit

Menu	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Total
www.gjp.gov.al	44259	39961	44804	44803	47909	45067	49063	46432	45102	48544	45026	46732	547702
Kendi Informativ	1289	1074	1184	1359	1336	1303	1352	642	899	1041	1066	1136	13681
Kalendari i çështjeve	475	384	460	433	463	484	539	189	363	381	347	374	4892
Çështje në gjykim	386	315	373	382	447	452	471	220	289	303	306	390	4334
Çështje të përfunduara	261	244	266	452	334	261	269	157	181	263	257	272	3217
Evidencat statistikore	167	131	85	92	92	106	73	76	66	94	156	100	1238
Gjykata e Posaçme	7591	5919	5247	5435	4801	5522	5208	4448	6118	6678	6747	6567	70281
Organizimi dhe struktura	168	149	111	99	133	129	104	86	118	165	122	180	1564
Orientimi në gjykatë	185	99	75	66	92	85	65	61	65	87	85	107	1072
Njoftime	2343	1896	1178	1326	1283	1119	1099	1038	1572	1796	1388	1863	17901
Vendime të Këshillit të Gjykatës së Posaçme	676	613	516	301	684	639	815	688	688	651	1056	644	7971
Urdhëra thirje për gjykim	4219	3162	3367	3643	2609	3550	3125	2575	3675	3979	4096	3773	41773
Programi i Transparencës	1812	1582	1146	1435	1228	1347	1253	1118	1463	1315	1307	1634	16640
Rregullore	452	351	182	333	270	254	246	279	387	292	325	381	3752
Programi i transparencës	106	121	64	64	67	66	71	61	51	49	51	66	837
Koordinatori për të drejtën e informimit	90	85	49	63	74	47	48	49	38	44	53	106	746
Njoftime për shtyp gjyqtari i medias GJ.K.K.O	1164	1025	851	975	817	980	888	729	987	930	878	1081	11305


Grafiku: Numri i aksesimit të faqes kryesore




Grafiku: Numri i aksesimit të Menu-ve kryesore




Grafiku: Numri i aksesimit të nën-rubrikës “Këndi informativ”



Grafiku: Numri i aksesimit të nën-rubrikës “Gjykata e Posaçme”



Grafiku: Numri i aksesimit të nën-rubrikës “Programi i Transparencës”



8.5.Sistemi Kompjuterik për çdo përdorues

Në sistemin kompjuterik për vitin 2022, u rinovuan 7 (shtatë) kompjutera dhe 2 (dy) lap-top, të cilët u instaluan dhe konfiguruan me programet kompjuterike të përshtatshme për punën e përditshme, *Microsoft Windows 10, Paketa Office, Pdf, Sistemi i Gjykatës (ARK IT, i përditësuar), Sistemi FTR, driver printim-i, folder share për skanim dokumentesh, konfigurimi i kufjeve usb, dhe kamera usb, për trajnime në distancë.*

Gjithashtu gjatë vitit 2022 u përditësuan të gjithë kompjuterët e gjykatës me SSD, ku u instalua sistemi Windows 10, paketa Office, Antivirus, etj, duke krijuar edhe backup-in e brendshëm të të dhënave të përdoruesit nga SSD, në HDD në intervale ditore.

8.6.Sistemi i printim/fotokopjes

Shërbimi i printimit përfshin pajisjet e printimit, fotokopjimit, skanimit dhe OCR. Ky shërbim është kontraktuar nga kompani e jashtme, e cila ofron çdo pajisje, bojë, shërbim fizik etj. Duke ofruar si shërbim fundor ~**1150000** (një milion e njëqind e pesëdhjetë mijë) kopje gjatë gjithë vitit 2022. Ky është realizuar nëpërmjet fotokopjeve profesionale dhe printerave. Të gjitha këto pajisje ndërlidhen në sistemin e rrjetit kompjuterik, duke ofruar mundësi që një përdorues të mund të printojë/skanojë informacionin e kërkuar për mbarëvajtjen e punës ditore.

8.7.Sistemi “Camera Station” për regjistrimin e pamjeve filmike të sigurisë fizike

Sistemi i sigurisë së kamerave për regjistrimin e pamjeve filmike, përbëhet nga kamera me teknologji të lartë ip, të shpërndara në dy regjistruues NVR. Kjo mundëson zgjatjen e kohës së mbajtjes dhe regjistrimit të të dhënave, sipas vendndodhjes dhe kërkesës së historikut.

Gjatë vitit 2022 u shtuan pikat e reja të monitorimit për punonjësit e sigurisë, me monitorim në kohë reale në tre vendndodhje të ndryshme.

8.8.Sistemi i skanimit dhe detektimit të hyrjes së personave të tretë

Ky sistem është instaluar si mjeti i parë i sigurisë fizike, për të mundësuar kontrollin fizik të çdo individit që hyn në ambientet e gjykatës. Gjithashtu kryen regjistrimin e fytyrës/bustit në mënyrë elektronike së bashku me temperaturën e personit hyrës, kjo e fundit për shkak të mbrojtjes nga virusi Covid-19.

8.9.Sistemi i dhomës teknike

Dhoma teknike “server room” është rinovuar gjatë viteve të fundit duke instaluar dysHEME teknologjike, kondicionim i alternuar për server room me ftohje të drejtpërdrejtë në rack, sistem BMS për detektim dhe lajmërim të parametrave të dhomës (*temperaturë, lagështirë, tym, voltazh të rrymës elektrike etj.*)

Sikurse gjatë vitit të kaluar 2021 edhe gjatë vitit 2022 u përditësuan dhe sistemuan here pas here terminimet e rrjetit kompjuterik, atij telefonik dhe ndërlidhjes së Switch-eve PoE për kamerat me

sistemin e UPS-ve për të pasur vijimësi në ofrimin e shërbimit edhe në rast shpërthimesh të energjisë elektrike.

8.10. Sistemi i mbrojtjes/shuarjes së zjarrit në ndërtesë dhe mjedise të posaçme

Ndërtesa e gjykatës është e pajisur me sistem për mbrojtjen kundër zjarrit qysh nga krijimi i saj. Ky sistem është funksional dhe mirëmbahet nga stafi teknik i ndërtesës. Paralelisht me këtë sistem, funksionojnë edhe tre sisteme të tjera për mbrojtjen dhe shuarjen e zjarrit, për mjedise të posaçme të cilat janë dhoma teknologjike “server room” dhe në dy mjediset e arkivës së gjykatës.

Këto sisteme kryejnë mbrojtje kundër tymit, nxehtësisë, me sensorët përkatës dhe janë të integruara me sistemin e shuarjes së zjarrit, përbërë nga gaz inert, i posaçëm për këto mjedise. Gjatë vitit 2022 u instalua sistemi i mësipërm tek dhoma e dytë e Arkivës, duke rritur kështu sigurinë fizike të materialeve të ruajtura në këtë hapësirë.

8.11. Sistemi i qendërzuar BMS i ndërtesës, dhe i mjediseve të posaçme

Sistemi BMS i ndërtesës është i integruar me sistem ngrohje/ftohje, kaldajë, ndriçim etj. Ky sistem është amortizuar, instaluar në një sistem operativ *Windows XP*, dhe nevojitet të zëvendësohet. Meqenëse është sistem i integruar me mjaft komponentë të përmendur më sipër është pothuajse e pamundur që sistemet e reja, të integrohen me to. Ndaj vazhdon të mirëmbahet nga stafi teknik.

Nga ana tjetër, të dhënat elektronike kanë përparësi të veçantë, në “server room, rrjedhimisht është instaluar një sistem i veçantë BMS sikurse është përmendur tek paragrafi paraardhës, ofron mjaft informacione të detajuara në monitorim dhe raportim në kohe reale.

8.12. Sistemi i telefonisë

Sistemi i telefonisë së gjykatës, është funksional dhe përbëhet nga një sistem i përzier dhe ofron linja hyrëse *analoge, digjitale* ashtu edhe hyrje nga *operator mobile*, por jo vetëm, pasi mbështet edhe protokoll *interneti SIP*.

8.13. Sistemi i aksesimit të sigurtë në mjediset e ndërtesës

Në ndërtesën e gjykatës është i instaluar sistem i kartave të aksesit në mjedise të gjykatës si dhe atyre të përbashkëta në varësi të rolit të përdoruesit, të personave fizikë (të stafit gjyqësor, dhe punonjësve të tjerë).

Pjesë integrale e këtij sistemi është edhe leximi i targave të automjeteve dhe hapja në mënyrë automatike të traut hyrës/dalës në parkimin e bodrumit të institucionit.

Në kuadër të rritjes së sigurisë së godinës, gjatë vitit 2022 u shtuan pikat e kontrollit dhe aksesit, për përdorimin e ashensorëve, hapjen e traut të parking-ut dhe mbyllja automatike e hyrjes së publikut jashtë orarit zyrtar, duke mundësuar identifikimin e çdo përdoruesi si gjatë orarit të punës ashtu edhe pas saj.

8.14. Ndërlidhja me Internet

Në vitin 2022, ndërlidhja ne internet, është realizuar nga shërbimi i qendëruar i KLGJ-së, duke u futur ne rrjetin e sigurt të të gjitha gjykatave, dhe aksesimin e simeve nga KLGJ-ja per efekt back-upi etj.

IV. MARRËDHENIET E GJKKO-së ME PALËT E TRETA.

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, GJKKO-ja, krijon dhe ndërton marrëdhënie me shumë institucione të tjera, me të cilat ka ura bashkëpunimi, për projekte të ndryshme, ndër të cilat, vlen të përmenden si më poshtë vijon:

1) Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me OSBE-në, në muajin Gusht 2021.

GJKKO-ja më datë 11.08.2021 ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me OSBE-në duke pasur si qëllim krijimin e një kuadri bashkëpunimi dhe bashkërendimi midis Prezencës së Përfaqësuesve të BE-së dhe Gjykatës së Posaçme në lidhje me zbatimin e projektit të financuar nga BE-ja mbi *“Mbështetjen për një administrim më efektiv të drejtësisë në rastet e korrupsionit dhe krimit të organizuar në Shqipëri përmes monitorimit të proceseve gjyqësore”*, marrëveshje e cila ka hyrë në fuqi me datën e nënshkrimit nga palët dhe është e vlefshme deri më datë 31.12.2023.

OSBE-ja ka një përvojë të madhe në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Në veçanti, operacionet në terren në Evropën Jug-Lindore dhe Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) janë të përfshira në një larmi aktivitete duke përfshirë këtu edhe: forcimin e kuadrit ligjor dhe institucioneve të vendeve pritëse; ndërgjegjësimi dhe ngritja e kapaciteteve të shoqërisë civile; dhe promovimin e institucioneve më transparente dhe të përgjegjshme. Në të kaluarën, OSBE ka zbatuar disa projekte monitorimi të seancave gjyqësore që synojnë vlerësimin dhe analizimin e zbatimit të ligjeve të reja të procedurave civile dhe administrative. Sidoqoftë, së fundmi, monitorimi i çështjeve penale nuk ka qenë në fokusin e aktiviteteve të Prezencës, kryesisht për shkak të mungesës së burimeve financiare dhe njerëzore. Pavarësisht kësaj, OSBE-ja ka mbështetur efikasitetin e procedurave gjyqësore duke zbatuar ndërgjegjësimin e synuar dhe aktivitetet e ndërtimit të kapaciteteve në të gjithë vendin. Me përvojën e saj në mbështetjen e institucioneve gjyqësore dhe reformën legjislative, Prezenca është në gjendje për të zhvilluar dhe zbatuar një program gjithëpërfshirës monitorimi të gjyqimit që synon vlerësimin e reagimit gjyqësor ndaj rasteve të korrupsionit dhe krimit të organizuar në mënyrë objektive dhe sistematike, që të rritet efektiviteti dhe efikasiteti i kapaciteteve të gjyqësorit dhe prokurorisë në hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e çështjeve të tilla.

Ky projekt do të zbatohet si pjesë e një veprimi rajonal të financuar nga Bashkimi Evropian, nën drejtimin e përgjithshëm dhe bashkërendimin nga Qendra e Parandalimit të Konfliktit të OSBE-së (QPK), së bashku me Misionet në terren të OSBE-së në Evropën Juglindore dhe me ndihmën e

ekspertëve nga Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR).

2- GJKKO raporton në mënyrë periodike, çdo 6 muaj pranë Ministrisë së Jashtme, Track-Record-et në lidhje me çështjet e Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, nëpërmjet të cilave shpjegohet ecuria e këtyre çështjeve në çdo fazë të gjyimit. Për plotësimin e Track-Rekordeve rakordohet me organin e Prokurorisë së Posaçme e cila pasi bën plotësimet përkatëse, i dërgon në Gjykatën e Posaçme dhe pasi kjo e fundit kryen plotësimet e saj, përcillen pranë Ministrisë së Jashtme.

Në kuadër të bashkëpunimit me Ministrinë e Jashtme, përfaqësues të GJKKO-së kanë qënë pjesëmarrës në raportimet e takimeve të Komitetit të Stabilizim-Asociimit Bashkimi Evropian – Shqipëri, i cili monitoron zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe plotësimin e kritereve të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

3- Në kuadër të integritetit të Shqipërisë në BE, Komisioni Evropian organizon rregullisht misione vlerësimi me vendet kandidatë dhe potenciale kandidatë për tu bërë pjesë në BE dhe ka si qëllim vlerësimin e kapaciteteve institucionale vendase për trajtimin në mënyrë efikase të rasteve specifike të korrupsionit të nivelit të lartë dhe krimin të organizuar.

Për shkak të çështjeve që janë në kompetencën e GJKKO-së, nga Bashkimi Evropian është dërguar një Komision Vlerësimi të cilët kanë si qëllim analizimin dhe vlerësimin bazuar në rastet e përfunduara të korrupsionit të nivelit të lartë dhe krimin të organizuar (përfshirë pastrimin e parave dhe konfiskimin e pasurive që rrjedhin nga aktiviteti kriminal), duke përfshirë institucionet që kanë trajtuar këto çështje gjatë fazës së hetimit dhe dërgimit për gjykim deri në dhënien e vendimit të formës së prerë.

Ekspertët kryen një studim të bazuar në rastet praktike, nëpërmjet një takimi të drejtpërdrejtë me gjyqtarët e kësaj gjykate, duke u bazuar në çështje të përfunduara që lidhen me veprat penale të korrupsionit të nivelit të lartë, pastrimit të parave dhe krimin të organizuar, raste të cilat u relatuan nga gjyqtarët dhe Zëvendëskryetarja e gjykatës. Në këtë kuadër, në datat 31.01.2022 deri më 04.02.2022 është zhvilluar takimi midis ekspertëve (gjyqtarë dhe prokurorë të Gjykatës dhe Prokurorisë së Posaçme), lidhur me rishikimin kolegjial të çështjeve konkrete të praktikës gjyqësore, për sa i takon misionit të TAIEK, në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar.

Misioni i ekspertëve të Komisionit Evropian, u informua lidhur me organizimin dhe funksionimin e GJKKO-se, numrin e gjyqtarëve faktike, organizimin e shortit të çështjeve, si dhe problematikat dhe vështirësitë e hasura për shkak të Reformës së Drejtësisë dhe shprehën njëkohësisht vlerësimin e tyre lidhur me arritjet e gjykatës në luftën kundër korrupsionit në nivele të larta dhe krimin të organizuar.

Në kuadër të integrimit të Shqipërisë në BE, me qëllim dhe përafrimin e legjislacionit të brendshëm me atë të BE-së, GJKKO u përfaqësua nëpërmjet Zëvendëskryetares në takimin shpjegues të mbajtur në qytetin e Brukselit, Belgjikë për Kapitullin 23 “*Gjyqësori dhe të drejtat themelore*”, më datë 27.09.2022, si dhe në takimin bilateral të zhvilluar në Bruksel, Belgjikë, po për Kapitullin 23 “*Gjyqësori dhe të drejtat themelore*”, më datat 24 dhe 25.11.2022.

4-Vlen të theksohet fakti se GJKKO bashkëpunon me Ministrinë e Drejtësisë në procesin e hartimit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim referuar Urdhërit nr.157, datë 30.12.2021, të Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë.

5- GJKKO ka marrëdhënie të ngushta bashkëpunimi me Komisionin e Posaçëm të Verifikimit të Pasurive të Figurës së Kandidatëve, i cili aktualisht ka finalizuar verifikimin e thelluar të kandidatëve për Oficerë në Byronë Kombëtare të Hetimit dhe do vijojë procedurën për verifikimin e thelluar të nëpunësit civil gjyqësor pranë GJKKO-së.

Referuar përcaktimeve të ligjit nr. 95/2016 “*Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar*”, nëpunësit civilë gjyqësorë në GJKKO, duhet të plotësojnë kushtet e sigurisë së mëposhtme: a) kontrolli i verifikimit të pasurisë dhe të figurës; b) dhënia e pëlqimit për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake si dhe të familjarëve të tyre, përpara se të caktohet apo punësohet në një nga pozicionet e punës. Gjykatat e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Prokuroria e Posaçme dhe Byroja Kombëtare e Hetimit krijojnë Komisionin e Posaçëm të Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve për të bërë verifikimin e kushteve të sigurisë para caktimit në detyrë ose emërimit.

Në këtë kontekst, punonjësit e administratës gjyqësore të GJKKO-së janë të detyruar të bëjnë deklaramin financiar vjetor në Inspektoratin e Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktin e Interesave. Mosdeklarimi ose deklarimi jo i plotë apo i rremë përbën shkak për pezullim të menjëhershëm dhe shkarkim të mundshëm si dhe kanë detyrimin e vazhdueshëm të përditësojnë deklaratën, sipas nevojës dhe të deklarojnë çdo konflikt interesi te kancelari, te gjyqtari apo te prokurori përkatës. Mosdorëzimi apo mospërditësimi i deklaratës apo deklarimi jo i plotë apo i rremë përbën shkak për pezullim të menjëhershëm dhe shkarkim të mundshëm. Po kështu, kanë detyrimin e vazhdueshëm për të ruajtur konfidencialitetin dhe sekretin e dëshmitarëve, provave, dokumenteve dhe të çdo informacioni tjetër në lidhje me hetimet e zyrës, me përjashtim të rasteve kur këto informacione janë bërë publike në përputhje me ligjin. Shkelja e këtij detyrimi përbën shkak për pezullim të menjëhershëm dhe shkarkim të mundshëm.

V. VEPRIMTARIA E GJYKATËS, AFATET KOHORE PROCEDURIALE DHE VLERËSIMI

1. Çështjet e paraqitura në gjykatë, kohëzgjatja, statistika mbi ankimin.

Numri i çështjeve të gjykuara nga GJKKO për vitin 2022 paraqitet si më poshtë:

Lloji i çështjeve		Çështje Penale	Seanca Paraprake	Kërkesa Penale	OFL	Masa sigurimi	Kërkesa për përgjime	Sekuesetro/Konfiskim sipas ligjit antimafia
Numri gjithsej	Çështje në pritje më 1 (një) Janar 2023	61	32	17	29	-	-	14
	Çështje në pritje më 31 (tridhejete e një) Dhjetor 2021	50	40	16	68	-	-	7
	Çështje të ardhura përgjatë viti 2022	89	113	569	4	96	1160	28
	Çështje të përfunduara përgjatë viti 2022	78	121	585	43	96	1160	35

Tabela: Statistika mbi shpejtësinë e përfundimit të çështjeve penale

Shpejtësia e gjykimit të çështjeve penale, për vitin 2022				
Lloji i Çështjes	0 - 6 muaj	6-12 muaj	Mbi 1 vit	Total
Penale Themeli	56	17	5	78
Në %	72%	22%	6%	100%

2. Statistika penale (çështje penale, seanca paraprake, masa sigurimi, kërkesa te tjera penale).

Tabela: Treguesit Statistikorë sipas Bashkimit European 01.01.2022 - 31.12.2022

Lloji i Çështjes	Nr. i çështjeve të përfunduara me 31 Dhjetor 2022	Nr. i çështjeve në gjykim me 31 Dhjetor 2022	Nr. i çështjeve të regjistruar gjatë vitit 2022
Dosje Penale Themeli	78	61	89
Seanca paraprake	121	32	113
OFL	44	28	4
Sekuestro/konfiskim sipas ligjit antimafia	21	14	28
Masa Sigurimi	96	0	96

Kërkesa penale	568	17	569
Përgjime	1160		1160
Totali	2088	152	2059

Tabela: Volumi i çështjeve gjyqësore sipas secilit gjyqtar të GJKKO

Nr.	Gjyqtar	Nr. çështjeve të mbartura nga vitet e mëparshme [1]	Nr. çështjeve të regjistruara të reja (nga data 01 janar) [2]	Nr. çështjeve të gjykuara [3]	Nr. çështjeve në shqyrtim [4]
1	Irena Gjoka	25	439	446	18
2	Etleva Deda	37	207	218	26
3	Flora Hajredinaj	33	224	234	23
4	Erjon Çela	29	288	299	18
5	Erion Bani	21	278	284	15
6	Atalanta Zeqiraj	17	402	406	13
7	Flojera Davidhi	15	183	183	15
8	Rudina Palloj	-	13	4	9
9	Elsa Ulliri	-	8	1	7
10	Sokol Pine (i deleguar)	1	1	2	-
11	Esmeralda Xhili (e deleguar)	1	-	-	1
12	Migena Laska (e deleguar)	-	1	-	1
13	Besnik Stroka (i deleguar)	-	1	1	-
14	Rexhep Bektashi (i deleguar)	1	1	2	-
15	Diamela Goxha (e deleguar)	1	12	8	5
16	Artan Cupi (i deleguar)	-	1	-	1
TOTALI		181	2059	2088	152

[1] Kjo e dhënë kërkohet vetëm në raportimin e parë tremujor të çdo viti.

[2] Numri aktual i çështjeve të reja të regjistruara që nga fillimi i vitit, (jo vetëm për tremujorin raportues)

[3] Çështje të gjykuara që nga fillimi i vitit deri në datën e raportimit (jo vetëm për tremujorin e raportimit)

[4] Numri i çështjeve në shqyrtim në momentin e raportimit

Tabela: Volumi i çështjeve penale ne vitin 2022

Volumi çështjeve penale të reja përgjatë vitit 2022							
Seanca Paraprake	Çështje Penale	Kërkesa Penale	OFL	Sekuestro/ Konfiskime	Masa Sigurimi	Përgjime	Totali
113	89	569	4	28	96	1160	2069

Grafiku: Volumi i çështjeve penale dhe hetimeve paraprake në vitin 2022




Tabela: Kërkesa penale gjatë vitit 2022

Kërkesa Penale	Të regjistruara në total	Të përfunduara	%	Të Pa - përfunduara	%
Zëvendësim mase sigurimi	100	96	96	4	4
Shuarje mase sigurimi	88	88	100	-	-
Informacion në lidhje me gjëndjen e procedimit	55	52	95	3	5
Ekzekutim leterporosie	50	49	98	1	2
Kundërshtimin vendimi të Prokurorisë për mosfillim procedimi penal	69	66	96	3	4
Shtyrje të ekzekutimit të vendimit	9	7	78	2	22
Kontroll banese	73	73	100	-	-
Rishikim vendimi	7	7	100	-	-
Perjashtim gjyqtari	13	13	100	-	-
Kthim sendi te sekuestruar	14	11	79	3	21
Bis	6	6	100	-	-
Zgjatje afati paraburgimi	21	21	100	-	-
Paraqitje e te dhenave kompjuterike	17	17	100	-	-
Sekuestro preventive	10	10	100	-	-
Bashkim denimesh	12	11	92	1	8
Marrje kampioni biologjik	2	2	100	-	-
Revokime gjobe	11	11	100	-	-
Të tjera	28	28	100	-	-
Totali	585	568	97	17	3

Grafiku: Kërkesa penale gjatë vitit 2022




Tabela: Masat e sigurimit të vendosura nga gjykata

Masa Sigurie	Të Regjistruara	Të Përfunduara	Të Papërfunduara
Totali	96	96	0

Grafiku: Masat e sigurimit të vendosura nga gjykata





Tabela : Detajimi i mënyrës së përfundimit të çështjeve penale 2022

Viti 2022	Me vendim fajësie	Me vendim pafajësie	Vendim Pushimi	Kthim për plotësim hetimesh	Vendosur moskompetenca	Totali
Sasia në nr	48	12	6	2	10	78
Sasia në %	62%	15%	8%	3%	13%	100%

Grafiku : Detajimi i mënyrës së përfundimit të çështjeve penale 2022



Nga ana e GJKKO-së, gjatë vitit 2022, është disponuar me vendim për 208 persona, prej nga rezulton se me vendime dënimi, janë dënuar 181 persona, me 11 vendime pafajësie janë shpallur 21 persona të pafajshëm dhe me 6 vendime pushimi është pushuar çështja për 6 persona.

Tabela : Detajimi i masave të dënimit të dhëna nga gjykata

Me gjobë	Deri 2 vjet	2-5 vjet	5-10 vjet	10-25 vjet	25-35 vjet	Burgim i përjetshëm	TOTALI
4	74	51	27	21	1	3	181

Grafiku : Detajimi i masave të dënimit të dhëna nga gjykata




Tabela : Detajimi i dënimeve të dhëna sipas gjinisë

Sasia	Të dënuar femra	Të dënuar meshkuj	Të dënuar gjithsej
Në numër	28	153	181
Në %	15%	85%	100%

Grafiku : Detajimi i dënimeve të dhëna sipas gjinisë




Tabela: Çështje penale të regjistruara gjithsej sipas dispozitave përkatëse penale për vitin 2022

Nenet	Emertimi i Nenit	Çështje të regjistruara	Çështje të përfunduara me vendim	Çështje të mbartura në 2023
78/a; 78/2; 333/a	Vrasje për gjakmarrje; Vrasja me paramendim, e kryer për interes, hakmarrje a gjakmarrje	11	3	8
79/a; 79/dh; 333/a	Vrasje e funksionareve publik; Vrasje në rrethana të tjera cilësuese - kundër dy ose më shumë personave	4	1	3
109/3; 333/a	Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit nën moshën 14 vjeç, i paraprirë a shoqëruar me tortura fizike ose psikike, i kryer kundër disa personave ose më shumë se një herë	1	1	-
134/3; 139; 140; 333/a	Vjedhja; Vjedhja me dhunë; Vjedhja me armë	4	2	2

186/2; 186/1; 189/2; 190, 312, 333/a	Përdorimi i dokumenteve të falsifikuara; Falsifikimi i dokumenteve; Përdorimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave të falsifikuara	5	4	1
244	Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike	4	1	3
245/1/2	Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike	10	9	1
248	Shpërdorimi i detyrës	9	9	
258	Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike	10	5	5
259	Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike	13	4	9
283/a/2; 333/a	Trafikimi i narkotikëve, në bashkëpunim ose më shumë se një herë	16	12	4
283/a/1; 333	Trafikimi i narkotikëve	-	-	-
283	Prodhim dhe shitja e narkotikëve	-	-	-
284/1; 333/a	Kultivimi i bimëve narkotike	3	-	3
287/a	Çelja e llogarive anonime	2	-	2
298/1; 333/a	Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit. Strehimi, shoqërimi, venia në dispozicion e mejteve ose përdorimi i tyre për të ndihmuar kalimin e paligjshëm të kufirit	5	2	3
289/3; 289/2	Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit, në bashkëpunim, më shumë se një herë ose me pasoja të rënda; Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit, e dhënë për qëllime fitimi	-	-	-
319/ç	Korrupsioni pasiv i gjyqtareve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë	2	2	-

319	Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë	3	2	1
333/a/1	Grupi i strukturuar kriminal, krijimi, organizimi ose drejtimi	1	-	1
119/1	Fyerja	2	-	2
120/1; 120/2	Shpifja; Shpifja botërisht, në dëm të disa personave, ose më shumë se një herë	24	18	6
257/a/2	Rrefuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë	4	-	4
328/1	Dhënia e shpërblimeve dhe premtimeve	5	2	3
230	Kryerja e veprimeve terroriste	1	1	-
Totali		139	78	61

Grafiku : Çështje penale të regjistruara gjithsej sipas dispozitave përkatëse penale për vitin 2022




Tabela : Disa prej çështjeve penale sipas llojit të vendimit

Lloji i veprave penale sipas neneve	Me vendim fajësie	Me vendim pafajësie	Pushuar	Moskompetencë, Bashkim i çështjes
Vrasje per gjakmarrje; Vrasja me paramendim, e kryer për interes, hakmarrje a gjakmarrje	1	-	-	2
Vrasje e funksionareve publik; Vrasje në rrethana të tjera cilësuese - kundër dy ose më shumë personave	1	-	-	-
Vjedhja; Vjedhja me dhunë; Vjedhja me armë	2	-	-	-
Përdorimi i dokumenteve të falsifikuara; Falsifikimi i dokumenteve; Përdorimi i letërnjoftimeve, i pasaportave ose i vizave të falsifikuara	1	1	-	1
Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike	-	-	-	-
Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike	9	-	-	-
Shpërdorimi i detyrës	9	-	-	3
Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike	3	1	-	-
Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike	3	1	-	1
Trafikimi i narkotikëve, në bashkëpunim ose më shumë se një herë	12	-	-	-
Trafikimi i narkotikeve	-	-	-	-
Kultivimi i bimëve narkotike				
Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit, në bashkëpunim, më shumë se një herë ose me pasoja të rënda; Ndihma për kalim të paligjshëm të kufirit, e dhënë për qëllime fitimi	2	-	-	-
Korrupsioni pasiv i gjyqtareve, prokuroreve dhe funksionareve te tjere te organeve te drejtesise	2	-	-	-

Korrupsioni aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë	2	-	-	-
Grupi i strukturuar kriminal, krijimi, organizimi ose drejtimi	-	-	-	-
Shpifja; Shpifja botërisht, në dëm të disa personave, ose më shumë se një herë	2	8	6	2
Fyerja	-	-	-	-
Dhënia e shpërblimeve dhe premtimeve	2	-	-	-
Kryerja e veprimeve terroriste	1			
Total	52	11	6	9

Tabelat e cilësisë së gjykimit të çështjeve në apel për vitin 2022

Çështje penale të ankimuara				
Përfunduar në gjykatën e Apelit				Aktualisht në Apel
Lënie në fuqi	Ndryshuar	Prishur e kthyer për rigjykim	Prishur dhe pushuar	
29	7	1	-	
Sasia 37				17
Totali 54				

Seanca paraprake të ankimuara				
Përfunduar në gjykatën e Apelit				Aktualisht në Apel
Lënie në fuqi	Ndryshuar			
7	1			
Sasia 8				-
Totali 8				

Kërkesa penale të ankimuara				
Përfunduar në gjykatën e Apelit				Aktualisht në Apel
Lënie në fuqi	Ndryshuar	Prishur e kthyer për rigjykim	Mospranim ankimi	
111	7	4	27	
Sasia 149				
Totali 149				

Gjatë viteve 2020 e 2021, GJKKO ka shqyrtuar një numër të konsiderueshëm kërkesash për sekuestrim e konfiskim pasurie, sipas parashikimeve të Aktit Normativ Nr.1, datë 31.01.2020 “Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit dhe sigurisë publike” që ka për objekt vendosjen e masave parandaluese personale dhe pasurore, sipas përmbajtjes së tij.

Theksojmë se gjatë vitit 2022, janë rregjistruar vërtet 4 kërkesa të reja në kuadër të Aktit Normativ, për shkak të përfundimit të efekteve të ligjit dhe ndërkohë janë gjykuar kërkesat e rregjistruara përgjatë viteve 2020-2021 në kuadër të Aktit Normativ të sipërcituar (OFL). Kërkesat me objekt konfiskim pasurie sipas këtij Akti Normativ, për shkak të kompleksitetit në shqyrtimin e tyre, kanë shtuar ngarkesën e gjyqtarëve në punën e tyre dhe kanë zgjatur në kohë si çështje. Kjo pasi nga gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor, në funksion të barrës së provës, në kuadër të një gjykimi sa më të drejtë e objektiv, janë thirrur ekspertë vlerësues të pasurive të paluajtshme dhe ekspertë kontabël të autorizuar për të vlerësuar pasuritë objekt konfiskimi, janë thirrur dëshmitarë (në disa prej çështjeve janë thirrur mbi 100 dëshmitarë), si dhe janë marrë të gjitha provat e kërkuara nga palët. Këto gjykime kanë sjellë si pasojë jo vetëm rritjen e ngarkesës së çështjeve për gjyqtarët, por edhe kohëzgjatjen e gjykimeve.

Kërkesa për sekuestrim dhe konfiskim pasurie sipas aktit normativ dhe ligjit antimafia të ankimuara				
Përfunduar në gjykatën e Apelit				Aktualisht në Apel
Lënie në fuqi	Ndryshuar	Prishur e kthyer për rigjykim	Mospranim ankimi	
8	1	0	3	
Sasia 12				
Totali 12				

Masa Sigurimi të ankimuara			
Përfunduar në gjykatën e Apelit			Aktualisht në Apel
Lënie në fuqi	Ndryshuar	Mospranim ankimi	
33	3	4	
Sasia 40			-
Totali 40			

Tabela: Cilësia e vendimeve penale themeli, Gjykata e Apelit

Gjykata Apelit (Penale)							
Gjyqtarët	Regj. Total	Përfunduar	L.Fuqi	Prish. Push	Ndry.	MosPr.	Prish. Kthyer
Irena Gjoka	11	4	1	-	1	-	-
Etleva Deda	20	12	3	-	-	-	-
Flora Hajredinaj	22	17	7	-	1	-	-
Erjon Çela	22	14	7	-	-	-	1
Erjon Bani	17	11	5	-	2	-	-
Flojera Davidhi	13	6	1	-	-	-	-
Atalanta Zeqiraj	17	10	2	-	2	-	-
Rudina Palloj	5	-	-	-	-	-	-
Elsa Ulliri	4	-	-	-	-	-	-
Sokol Pine (i deleguar)	1	1	1	-	-	-	-
Diamela Goxhaj (e deleguar)	2	1	-	-	1	-	-
Rexhep Bekteshi (i deleguar)	1	1	-	-	-	-	-
Besmir Stroka (i deleguar)	1	1	1	-	-	-	-
Esmeralda Xhili (e deleguar)	1	-	-	-	-	-	-
Migena Laska (e deleguar)	1	-	-	-	-	-	-
Artan Çupi (i deleguar)	1	-	-	-	-	-	-
Totali	139	78	28	-	7	-	1

VI. PARAQITJE DHE ANALIZË E TREGUESËVE STATISTIKORË NË VITE

1. Ngarkesa e çështjeve

Ngarkesa e Gjyqtareve të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për çështje të gjykuara si kryesues e anëtare në trup gjykues.

Gjyqtar / e	Çështje të gjykuara	Penale		Kërkesa Penale
		I vetëm dhe Kryesues	Trup Gjykues	
Irena Gjoka	460	4	14	442
Etleva Deda	221	12	3	206
Flora Hajredinaj	238	17	4	217
Erjon Bani	309	11	13	285
Erjon Çela	299	14	12	273
Atalanta Zeqiraj	423	10	17	396
Flojera Davidhi	200	6	17	177
Rudina Palloj	4	-	-	4
Elsa Ulliri	1	-	1	1
Sokol Pine (i deleguar)	3	1	1	1
Diamela Goxhaj (e deleguar)	9	1	1	7
Rexhep Bekteshi (i deleguar)	1	1	-	-
Besmir Stroka (i deleguar)	1	1	-	-
Genti Dokollari (i deleguar)	1	0	1	-
Adelajda Gjuzi (e deleguar)	1	-	1	-
Matilda Llangozi (e deleguar)	1	-	1	-
Arbana Selmanaj (e deleguar)	1	-	1	-
Gert Hoxha (i deleguar)	1	-	1	-
Esmeralda Xhili (e deleguar)	1	-	1	-
Migena Laska (e deleguar)	1	-	1	-
Manjola Xhaxho (e deleguar)	1	-	1	-
Alma Kolgjoka (e deleguar)	1	-	1	-
Petrit Çomo (i deleguar)	1	-	1	-
TOTAL	2179	78	93	2009

2. Tërësia e çështjeve të trajtuara në vitet 2004-2019

Nëpërmjet kësaj table paraqesim të dhënat për treguesit e ngarkesës në vite që nga krijimi i gjykatës për të kuptuar dhe mënyrën e evoluimit të natyrës së çështjeve penale në kompetencën e gjykatës sonë, si dhe për të pasqyruar ngarkesën e gjykatës.

Tabela: Tërësia e çështjeve të trajtuara në vitet 2004-2019 nga ish Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda

Tërësia e çështjeve të trajtuara në vite																
Në vite	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Çështje Gjyqësore	140	141	123	124	145	136	111	118	130	171	221	234	211	190	183	142
Masa sigurimi	237	257	266	266	277	181	354	217	312	332	584	535	451	446	198	173
Kërkesa të tjera	96	294	587	550	577	656	926	661	782	901	1432	1473	1333	1755	1749	1591
Sekuestro Konfiskim		14	41	27	22	18	22	17	21	13	31	35	35	33	27	20
Seanca paraprake														49	138	134
Total	473	706	1008	967	1021	991	1413	1013	1245	1417	2268	2277	2030	2473	2295	2060

Tabela: Tërësia e çështjeve të trajtuara në vitet 2020-2022 nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

Tërësia e çështjeve të trajtuara në vitet 2020 - 2021-2022			
Tipi i çështjes	2020	2021	2022
Çështje Gjyqësore	96	149	139
Masa sigurimi	126	106	96
Kërkesa të tjera	1541	1737	1745
Sekuestro Konfiskim sipas ligjit Antimafia	30	43	35
Seanca paraprake	102	127	153
Sekuestro konfiskime sipas Aktit Normativ Nr.1, viti 2020	240	199	72
Total	2135	2361	2240

Siç rezulton nga përmbajtja e tabelave më sipër, volumi i punës të çështjeve të shqyrtuara nga viti 2019, krahasuar me vitet 2020 dhe 2021 ka pësuar një rritje, e konkretisht 3.6% për vitin 2020 dhe 10.6 % për vitin 2021. Referuar numrit total të çështjeve të përfunduara për vitin 2022, vihet re një ulje e këtij numri në masën 5,2% (121 çështje më pak) në krahasim me vitin 2021. Nga analiza e deajuar e natyrës së çështjeve vëmë re se për çështjet e themelit, numri i tyre për vitin 2022 (139 çështje) është i përafërt me ato të vitit paraardhës. Numri i kërkesave për “Masa Sigurimi” (96 çështje) ka pësuar një ulje të lehtë me vitin 2021, por është rritur kompleksiteti i shqyrtimit të tyre, pasi ka një numër të madh të madh personash (me mbi 50 persona në një kërkesë), për të cilët kërkohet caktimi i masave të sigurimit dhe për rrjedhojë nënkupton edhe një ngarkesë më të madhe pune për gjyqtarët. Edhe numri i kërkesave për Sekuestro/Konfiskime për vitin 2022 është i përafërt me vitet paraardhëse. Rezulton se është rritur ndjeshëm numri i Seancave Paraprake (153

çështje), në krahasim me vitin parardhës, seanca me një numër të konsiderueshëm të pandehurish, fakt që reflekton në rritjen e ngarkesës së punës së gjyqtarëve.

Numri i kërkesave për Sekuestro/Konfiskime sipas Aktit Normativ nr.1, viti 2020 (OFL), ka pësuar ulje në vitin 2022 (72 çështje) për shkak të përfundimit të efekteve ligjore të Aktit normativ.

Duhet mbajtur parasysh fakti se në vitet 2020, 2021 dhe 2022 trupa gjyqësore ka qenë me numër të reduktuar gjyqtarësh.

3. Çështje të gjykuara me objekt sekuestrim dhe konfiskim pasurie.

Tabela: Sekuestro të vendosura me Ligjin Antimafia, viti 2022

Sekuestro gjatë vitit 2022, sipas ligjit Antimafia	
❖ Vlera monetare	
• Aksione ne 6 Kompani shpk • Kuotat ne dy shoqëri • Kuotat ne kompani • Kuotat ne 4 shoqeri	
❖ Pasuri të paluajtshme	
• Pasurisë së paluajtshme llojit tokë arë, me sipërfaqe 500 m² Lushnje, • Pasurisë së paluajtshme me sipërfaqe 500 m², Lushnje. • Pasurisë së paluajtshme e llojit apartament, me sipërfaqe 91.50 m², Tiranë, • Pasurisë së luajtshme autoveturë e markës “BMW” • Pasuria me sip 1290 m2 Tirane • Pasuria me sip 120 m2 Tirane • Pasuria me sip 302 m2 Tirane • Pasuria me sip 1680 m2 Tirane • Pasuria me sip 6530 m2 Tirane • Pasuria me sip nr.5560 m2 Tirane • Pasuria me sip nr.3930 m2 Tirane • Pasuria me sip nr.1670 m2 Tirane • Pasuria me sip nr.480 m2 Tirane • Pasuria me sip 84.4 m2 Tirane • Pasuria me sip 57.8 m2 Tirane • Pasuria me sip 700 m2 Tirane • Pasuria me sip 2092 m2 Tirane • Pasuri e paluajtshme me sip 103 m2 Durrës • Pasuria e paluajtshme me sip 51 m2 Durrës • Pasuria e paluajtshme me sip 1809 m2 Kavajë • Pasurie me sip 500 m2 Pogradec • Pasurie me sip 37 m2 Elbasan	

- Pasuria me sip 1756 m² Elbasan
- Pasuria me sip 499 m² Elbasan
- Pasuria me sip 360 m² Elbasan
- Pasuria me sip 720 m² Elbasan
- Pasuria me sip 764 m² Elbasan
- Pasuria me sip 1380 m² Elbasan
- Pasuria me sip 2968 m² Elbasan
- Pasuria me sip 2720 m² Elbasan
- Pasuri are me sip 60 m² Tiranë

❖ Automjete

- Automjet tip Mercedes- Benz CLS
- Automjet tip Mercedes- Benz G63AMG
- Automjet tip Mercedes- Benz GLE 400 d
- Automjeti Volkswagen
- Automjet marka Audi
- Automjet autobus i markës Volvo
- Automjeti autoveture i markës Mercedes Benz
- Automjeti i markës Daimler Benz
- Trailer
- Automjeti Marka Nisan
- Automjeti i markës Mercedes Benz
- Automjeti marka Opel

Tabela: Konfiskime të vendosura me Ligjin Antimafia, viti 202

Konfiskime gjatë vitit 2022, sipas ligjit Antimafia	
Vlera monetare	
Kuota ne 11 Kompani	
Pasuri të paluajtshme	
Pasurisë së paluajtshme llojit tokë arë, me sipërfaqe 187 m ² Lezhë	
Pasurisë së paluajtshme me sipërfaqe 179 m ² , Lezhe	
Pasuria e llojit “truall”, me sipërfaqe 300 m ² , Tiranë.	
Pasuria e llojit “njësi shërbimi”, me sipërfaqe 43.7 m ² , Tiranë.	
Pasuria e llojit “arë”, me sipërfaqe 67.3 m ² , Tiranë.	
Pasuria e llojit “truall”, me sipërfaqe 15 m ² , Tiranë.	
Pasuria e llojit “truall”, me sipërfaqe totale 2026 m ² , Tiranë.	

Pasuria e llojit “pyll”, me sipërfaqe totale 100 000 m², Lanabregas, Tiranë.

Pasuria e paluajtshme e llojit “truall”, me sipërfaqe 8 781 m², Tiranë.

Pasuria e paluajtshme e llojit “njësi”, me sipërfaqe 150 m², Tiranë

Pasuria e paluajtshme e llojit “njësi”, me sipërfaqe 18.3 m², Tiranë,

Pasuria e paluajtshme e llojit “njësi”, me sipërfaqe 195.1 m², Tiranë.

Pasuria e paluajtshme e llojit “garazh”, me sipërfaqe 29.4 m², Tiranë.

Automjeti i tipit autoveturë, marka “Mercedes-Benz”, modeli S600.

Automjeti i tipit autoveturë, marka “BMW”.

Automjeti i tipit autoveturë, marka “Mercedes-Benz”.

Automjeti i tipit autoveturë, marka “Rolls Royce”, modeli PHANTOM.

VII. OBJEKTIVA DHE REKOMANDIME

➤ Objektiva

Analiza vjetore e punës për vitin 2022 e GJKKO-së është një mënyrë efikase për të evidentuar veprimtarinë e kryer nga institucioni gjatë këtij viti, për të reflektuar progresin e kryer, mangësitë e konstatuara dhe mundësitë për të bërë përmirësime. Në këtë analizë gjen vend edhe përcaktimi i objektivave respektivë për të ardhmen, me qëllim përmirësimin e cilësisë së punës së gjithësecilit në funksion të ofrimit të shërbimeve dhe dhënies së drejtësisë.

Objektivat e GJKKO-së konsistojnë në ndërmarrjen e të gjitha masave të nevojshme dhe imediate me qëllim rritjen e performancës së këtij institucioni. Nëpërmjet tyre synohet në rritjen e kapaciteteve dhe efijencës në punë të gjyqtarëve dhe administratës gjyqësore, duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në dhënien e drejtësisë, si dhe ngritjen e standarteve aktuale drejt atyre europiane.

Gjatë vitit të ardhshëm, GJKKO ka si synim, të marrë masa efektive në disa drejtime:

- Rritjen e cilësisë dhe profesionalizmit në funksion të dhënies së vendimeve gjyqësore, si dhe shërbimeve gjyqësore në tërësi të ofruara pranë GJKKO-së;
- Rritjen e efektivitetit dhe efijencës së proceseve gjyqësore;
- Ofrimi i një shërbimi cilësor në të gjitha aspektet, me synim rritjen e besueshmërisë së publikut në procesin e dhënies së drejtësisë;
- Rritjen e aksesit të publikut dhe medias në gjykatë, nëpërmjet një procesi proaktiv;

- Ngritjen e kapaciteteve dhe rritjen e transparencës ndaj veprimtarisë së GJKKO-së, duke synuar njëkohësisht mbrojtjen e të dhënave personale të palëve në proces, në zbatim të legjislacionit përkatës;
- Forcimin e bashkëpunimit me aktorë të tjerë në fushën e drejtësisë shqiptare dhe asaj ndërkombëtare;
- Kryerjen e përmirësimeve të sistemit të menaxhimit të çështjeve gjyqësore;
- Shtimin e burimeve njerëzore të gjykatës, si dhe trajnimin e tyre fillestar dhe vazhdues, me qëllim rritjen e cilësisë dhe performancës së shërbimeve të ofruara.

Objektiva afatshkurtër dhe afatmesëm janë:

- Plotësimi sa më i shpejtë i vendeve vakante për gjyqtarë në organikën e gjykatës, me qëllim shpërndarjen e ngarkesës së konsiderueshme të çështjeve gjyqësore, që kanë gjyqtarët aktualë;
- Përmirësim i vazhdueshëm i kushteve të punës, lidhur me rinovimin e teknologjisë kompjuterike dhe arkivës;
- Përpunimi i dosjeve gjyqësore për ruajtje të përhershme/përkohshme dhe asgjësim, proces i cili do të realizohet në bashkëpunim me KLGJ-në;
- Zëvendësimi i procesit manual të anonimizimit të vendimeve voluminoze gjyqësore, nëpërmjet metodave të tjera efikase me mjete teknologjike;
- Ngritja e platformës për komunikimet elektronike, në bashkëpunim me KLGJ dhe KE;
- Rritja e komunikimit me aktorët e tjerë në fushën e drejtësisë, si: Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, KLGJ-në, Gjykatën Kushtetuese, Gjykatën e Lartë, gjykatat dhe prokuroritë e rretheve gjyqësore, Ministrinë e Drejtësisë, Komisioni i Pavarur i Kualifikimi dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit, Shkollën e Magjistraturës, Dhomën Kombëtare të Avokatisë, Policinë e Shtetit, Zyrat e Përmbarimit, Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, Zyrat Vendore të Shërbimit të Provës, Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, duke planifikuar dhe kryer takime periodike me ta, për të evidentuar, diskutuar dhe zgjidhur problematika të ndryshme;
- Rritja e aksesit të publikut dhe medias në gjykatë, si dhe trajtimi i barabartë i tyre;
- Monitorimi i vazhdueshëm mbi zbatimin e marrëveshjes me Postën Shqiptare sh.a., për sa i përket cilësisë dhe shpejtësisë së kryerjes së shërbimit të dorëzimit të dokumentacionit gjyqësor;
- Kryerja e trajnimeve për administratën gjyqësore e sidomos për sekretarinë gjyqësore në drejtim të përmirësimit të aftësive kompjuterike, etikës së komunikimit me publikun dhe zbatimit të ndryshimeve të reja ligjore, etj.

- Monitorimi i zbatimit të rregullave të funksionimit të teknologjisë së informacionit në gjykatë.

➤ **Për arritjen e këtyre objektivave rekomandojmë:**

1. Rritja e bashkëpunimit të GJKKO-së me KLGJ-në për plotësimin sa më të shpejtë të pozicioneve vakante për gjyqtarë sipas organikës së GJKKO-së;
2. Bashkëpunimi i GJKKO-së me KLGJ-në, për gjetjen e zgjidhjeve efikase, për zëvendësimin e procesit manual të anonimizimit të vendimeve gjyqësore nëpërmjet mjeteve teknologjike, për shkak të volumit të madh që këto vendime kanë, si dhe për të shmangur pasaktësi të mundshme që ndodhin gjatë procesit manual të anonimizimit;
3. Rritja e bashkëpunimit me donatorët dhe partnerët ndërkombëtarë, lidhur me çështje të trajnimit të administratës gjyqësore dhe çështje të tjera;
4. Angazhim i punonjësve të trajnuar dhe eksperteve të jashtëm për ato çështje ku vlerësohet e nevojshme;
5. Ngritje e grupeve të monitorimit për secilën nga objektivat dhe raportim mujor mbi ecurinë e tyre nga grupet e punës përpara Këshillit të Gjykatës;
6. Monitorim periodik nga Këshilli i Gjykatës në lidhje me objektivat e caktuara dhe ndjekjen e ecurisë të secilës prej objektivave;
7. Paraqitjen e raporteve periodike KLGJ-së, si dhe kërkesa kësaj të fundit në lidhje me problematikat që kërkojnë ndërhyrjen e KLGJ-së për zgjidhjen e situatave.

Në përfundim, duke përfituar nga rasti, shprehim falenderime për të gjithë gjyqtarët, administratën gjyqësore, si dhe gjithë stafin e gjykatës, të cilët me angazhimin e tyre kanë bërë të mundur përmbylljen e suksesshme të vitit 2022.

Falenderime të mëtejshme i takojnë edhe KLGJ-së për bashkëpunimin e vazhdueshëm dhe ndihmesën e dhënë prej saj në zgjidhjen e problematikave të hasura gjatë kësaj periudhe, duke bërë të mundur, rritjen e cilësisë dhe efikasitetit në punë të gjykatës sonë.

KËSHILLI I GJYKATËS